



Puna me të Rinjtë/Rejat

në Rrezik në Ballkan

Një rast studimor mbi Programin Y+



***Puna me të Rinjtë/Rejat në Rrezik në Ballkan
Një rast studimor mbi Programin Y +***

Autorë:

Branko Birač dhe Olga Bogdanov

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive	4
1. Rreth Iniciativës së Burrave të Rinj (YMI)	7
2. Sfondi dhe metodologjia	11
2.1. Ekstremizmi dhe radikalizimi	11
2.2. Shtytësit e ekstremizmit të (dhunshëm)	14
2.3. Metodologjia	18
3. Rastet studimore	20
3.1. Angazhimi i komunitetit në procesin e parandalimit të radikalizimit të të rinjve/rejave	21
3.2. Qendrat për Punë Sociale si pika të komunitetit lokal për parandalimin e radikalizimit	24
3.3. Qendra e Paraburgimit për të Mitur si vend për risocializimin e të rinjve	29
3.4. Angazhimi i palëve të interesit dhe të rinjve/rejave lokalë/e në parandalimin e ekstremizmit të të rinjve/rejave	32
3.5. Edukimi me bazë në teatër si përgjigje ndaj çështjeve të ekstremizmit në zhvillim	36
4. Konsideratat përfundimtare dhe rekomandimet	40
5. Partnerët pjesëmarrës	49
Literatura	51



Përmbledhja ekzekutive

Rasti studimor shqyrton në hollësi procesin e zhvillimit dhe pilotimit të modelit për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit rinor (Programi Y +) që u krye në kuadër të projektit Iniciativa e Burrave të Rinj “Burrat dhe Djemtë si Partnerë në Promovimin e Barazisë Gjinore dhe Parandalimin e Ekstremizmit dhe Dhunës Rinore në Ballkan” të zbatuar nga CARE International Balkans dhe organizatat partnere në periudhën 2017-2020. Programi Y + i kushtohet parandalimit të ekstremizmit dhe dhunës rinore, si dhe rritjes dhe forcimit të lidhjeve me komunitetin dhe adresimin e shtresave të shumta të përjashtimit që shpesh çojnë në ekstremizëm. Ai po zbatohet nga pesë organizata partnere në pesë vendet e shënjestruara: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, dhe Serbi. Objektivi kryesor i këtij studimi cilësor ishte ravijëzimi i elementeve thelbësorë të ndikimit të Programit Y + tek të rinjtë, prindërit, mësuesit dhe palët e tjera të interesit / anëtarët e komunitetit. Intervistat u kryen me ndihmën e organizatave partnere Perpetuum Mobile (Banja Llukë), Qendra E8 (Beograd), SIT (Prishtinë), Vepro për Shoqërinë (Tiranë), Status-M (Zagreb), përfaqësuesit e të cilave gjithashtu morën pjesë.

Ky rast studimor u mbështet në një metodologji specifike e cila konsistonte në një analizë të thelluar të literaturës për të fituar njohuri për konceptet bazike dhe për të operacionalizuar koncepte të tilla si ekstremizmi dhe radikalizmi, si tek të rinjtë ashtu edhe tek popullata e përgjithshme. Pas analizës së literaturës (desk analysis), u realizuan pesë intervista në grup me organizata lokale partnere, mësues nga shkollat që ishin pjesë e projektit, trajnerë që morën pjesë në punëtori dhe përfitues të programit, në të gjitha vendet e shënjestruara të projektit.

Gjetjet e këtij rasti studimor duhet të shërbejnë si një pikënisje për zhvillimin e ardhshëm të programit si dhe për të dokumentuar progresin në trajtimin e të rinjve në rrezik në Ballkan. Modelet e pilotuara arritën sukses duke aplikuar qasje dhe metoda të ndryshme, dhe gjetjet kryesore tregojnë se organizatat partnere pjesëmarrëse demonstrojnë kreativitet dhe përkushtim, dhe se qasjet e tyre specifike ishin të një cilësie të lartë. Aktivitetet e zbatuara ishin shumë të dobishme për pjesëmarrësit rinorë dhe Y + dëshmoi veten si një program parandalues premtues në këtë fushë.

Edhe pse faza e pilotimit tregoi rezultate të mira, ka hapësirë për përmirësimin dhe standardizimin e mëtejshëm të qasjeve të pilotuara, e cila është edhe arsyeja pse zbatimi i Programit Y + duhet të vazhdojë në periudhën vijuese, në mënyrë që të standardizohen metodologjitë që organizatat partnere do të përdorin në të ardhmen. Vetëm me punë të vazhdueshme dhe përmirësime të mëtejshme, programi Y + do të arrijë potencialin e tij të plotë për t’u bërë një program efektiv, i mirëbalancuar, gjithëpërfshirës dhe i shkallëzueshëm që siguron rezultate në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit rinor.

Ky rast studimor është menduar për përdorim nga ekipi i YMI (CARE dhe partnerët), si dhe për të gjithë palët përkatëse të interesit (personelin shkollor, punonjësit socialë, OJQ-të kombëtare dhe ndërkombëtare, etj.) që mund të jenë të interesuara të bashkëpunojnë dhe t’i bashkohen përpjekjeve të ardhshme të YMI-së për të parandaluar radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm.



CARE International në Ballkan

CARE International ka mbi 25 vjet përvojë në zbatimin e programeve në rajonin e Ballkanit. Gjatë luftërave dhe konflikteve të viteve 1990, CARE iu përgjigj shkatërrimit, traumatizimit, zhvendosjes dhe mosbesimit ndëretnik me aktivitete masive humanitare dhe jetëshpëtuese në të gjithë Ballkanin. Që nga viti 2000, orientimi i CARE ka kaluar në punën zhvillimore. Sot, qëllimi i tij në Ballkan është të sigurojë që të drejtat sociale, ekonomike dhe politike të grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara të njihen dhe plotësohen, duke kontribuar në paqen e qëndrueshme në rajon.

Strategjia e Programit CARE bazohet në dy shtylla: a) *përfshirja socio-ekonomike* e pakicave të cënueshme dhe grupeve të tjera të marginalizuara duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve dhe duke krijuar mundësi më të mira për ta, duke u mundësuar atyre që të integrohen në shoqëri dhe të përmbushin të drejtat e tyre; b) *barazia gjinore* midis grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara duke promovuar vlerat dhe praktikën e barazisë gjinore, diversitetit dhe mosdhunës, forcimin e kapaciteteve të akterëve lokalë, kombëtarë dhe rajonalë të të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale, si dhe krijimin e mundësive për inovacion, pjesëmarrje, të mësuarit, bashkëpunimin dhe avokimin. CARE ushqen partneritete me sektorin lokal të shoqërisë civile dhe qeveritë të dedikuara për krijimin e ndryshimeve pozitive në shoqëri.



Ky publikim është mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Fondacioni Oak. Përmbajtja dhe gjetjet e këtij publikimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverive austriake dhe zvicerane, ose fondacionit Oak.



Përmbledhje ekzekutive



1. Rreth Iniciativës së Burrave të Rinj (YMI)




Iniciativa e Burrave të Rinj (YMI) është një vazhdim i përpjekjeve gjithëpërfshirëse dhe programore të CARE për të parandaluar dhunën ndërpersonale dhe me bazë gjinore (DhBGj), si dhe për të promovuar barazinë gjinore në rajon. YMI shënjestron të rinjtë për të konsoliduar njohuritë dhe qëndrimet e tyre në lidhje me barazinë gjinore dhe mënyrat e shëndosha të jetesës, dhe për të zvogëluar të gjitha llojet e dhunës. Ai trajton çështjet e dhunës, pabarazisë gjinore dhe diskriminimit, normave gjinore stereotipike dhe të dëmshme, çështjet e drogës dhe abuzimit me alkoolin, si dhe atë të shëndetit seksual dhe riprodhues - duke prezantuar programin transformues gjinor në sistemet arsimore në të gjithë Ballkanin. Që nga fillimi i saj në vitin 2006, YMI ka punuar në zhvillimin e qëndrimeve dhe sjelljeve të shëndosha, jo të dhunshme dhe të barabarta gjinore midis djemve dhe burrave, si dhe vajzave dhe grave që marrin pjesë në program. Përveç rinisë, YMI gjithashtu angazhon mësues, prindër, punëtorë rinorë, vendimmarrës nga ministrinë dhe vetëqeverisja lokale, punëtorë socialë, media, organizata të shoqërisë civile dhe të tjerë, duke mbledhur kështu të gjithë këto palë të ndryshme të interesit nën ombrellën e vizionit të përbashkët - një vizion i një shoqërie pa dhunë dhe me barazi gjinore.

YMI zbatohet nga CARE Ballkan në bashkëpunim të ngushtë me 10 organizata partnere nga tetë qytete: Banja Lluca, Beogradi, Mostari, Mitrovica e Veriut, Prishtina, Sarajeva, Tirana dhe Zagrebi. Gjatë viteve të mëparshme, YMI nuk u kufizua vetëm në qytetet e lartpërmendura dhe aktivitetet e saj u përshkallëzuan ndjeshëm, duke arritur më shumë se 140 qytete / komuna të ndryshme dhe mbi 720,000 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë përmes mijëra aktiviteteve arsimore, avokuese dhe / ose të fushatës. Arritja totale indirekte dhe arritja e mediave me gjasë kapë miliona njerëz.

Implementimi i projektit YMI nga CARE Balkans

10 organizata partnere nga 8 qytete:



Këto shifra, si dhe jetëgjatësia e YMI-së, japin dëshmi për shtrirjen dhe ambicien e përpjekjeve të YMI-së. Për më tepër, CARE, stafi i organizatave partnere dhe përfituesit vënë në pah se YMI dhe “Bonu Burrë” (fushata e saj ombrellë dhe parulla) nuk janë vetëm projekte, por edhe një “mënyrë jetese”. Një hulumtim gjithëpërfshirës që krahason hulumtimet pikënisje dhe ato përmbyllëse në vendet e shënjestruara tregoi një ndryshim të rëndësishëm pozitiv në secilën nga katër fazat e projektit (nga 2006 në 2020). Për më tepër, dëshmi të shumta dhe intervista me përfituesit vërtetojnë se programet edukative të YMI ushtrojnë një ndikim të rëndësishëm që çon në ndryshime pozitive në qëndrime dhe sjellje.

Programet edukative ishin gjithmonë baza e përpjekjeve të YMI, që nga zanafilla e saj. Gjithçka filloi me Programin M (një doracak për punën specifike me burra të rinj) bazuar në Programin H të Promundo-s dhe përshtatur me kontekstin e Ballkanit, duke u mbështetur në rezultatet e hulumtimeve cilësore dhe sasore në vendet pjesëmarrëse. Programi Y ishte hapi i radhës, evolucioni i mëtejshëm i Programit M, i paraparë për grupe të përziera gjinore dhe kështu për ngritje në shkallë për një numër më të madh të nxënësve. Përveç punës së vazhdueshme me të rinjtë, një trajnim për stafin shkollor (d.m.th. mësues, pedagogë, psikologë), u zhvillua, akreditua dhe zbatua në të gjithë Ballkanin, duke u mundësuar stafit të shkollave të realizojnë punëtori vetë dhe të mbështesin nxënësit e tyre dhe edukatorët e tyre bashkëmoshatarë (kolegialë). Klubet “Bonu Burrë” (KBB) janë një tjetër forcë specifike e programit, pasi ato janë klube të të rinjve aktivistë me anëtarë që janë studentë dhe edukatorë bashkëmoshatarë të përfshirë në program. KBB-të bazohen në pjesëmarrjen e të rinjve dhe angazhimin e të rinjve, dhe përqendrohen në sajimin, organizimin dhe zbatimin e veprimeve të ndryshme publike brenda shkollave dhe komuniteteve, të cilat përhapin më tej mesazhet dhe vlerat e programit. Procesi participativ ishte gjithmonë një nga tiparet kryesore të YMI dhe të rinjtë ishin gjithnjë të angazhuar në zhvillimin e programeve dhe fushatave të reja.

Një nga qasjet dhe idetë “taze” në zhvillimin e programit rinor ishte krijimi i një programi të ri edukativ të përshtatur posaçërisht për të rinjtë në rrezik në Ballkan. Programi u bazua në programimin transformues gjinor të CARE, me fokusin e tij kryesor **parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të të rinjve**. Në fillim të vitit 2019, CARE dhe organizatat partnere filluan zhvillimin e një modeli të ri plus të Programit Y (Youth-Rinia) si një përgjigje ndaj mjedisit në ndryshim dhe kërkesës për kundërradikalizimin e të rinjve. Ideja fillestare e pilotimit ishte të adresonte çështjen e ekstremizmit dhe radikalizimit midis të rinjve në rrezik, të rinjve jashtë shkollës, delikuentëve të mitur dhe të rinjve të papunë.

Aktivitete të tjera domethënëse të YMI përfshijnë kampe të ndryshme rinore dhe trajnime rezidenciale, konferenca për ekspertë dhe të rinj, shfaqje teatrale shoqërisht të angazhuara, filma dhe video klipe, aktivizime të mediave sociale, etj. Shtesat më të fundit dhe të ardhshme në këtë bollëk aktiviteteesh (p.sh. zhvillimi i trajnimit online për mësuesit, programet për shkollat fillore, ndërtimin e lëvizjeve, etj.) duken shumë premtuese dhe tregojnë se ka shumë më tepër për të pritur nga YMI.



Sfondi dhe metodologjia

2. Sfondi dhe metodologjia

2.1. Ekstremizmi dhe radikalizimi



Ekstremizmi. Megjithëse termi ekstremizëm është përdorur që nga Greqia antike, kuptimet e tij origjinale nuk kanë ndryshuar aq shumë. Depolitizimi i këtij nocioni është padyshim një fenomen i epokës moderne, si dhe lidhja e tij me fenomene të tjera, të tilla si radikalizimi i dhunshëm, terrorizmi, maskuliniteti, etj. Nocioni i ekstremeve politike është i rrënjësor në etikën e Greqisë antike, dhe si Platoni ashtu dhe Aristoteli u përpogën ta përkufizojnë atë. Kontinuumi i formave qeveritare të Platonit përthekonte ekstremet e despoteia / tyrannis dhe anomia / forma e paligjshme e demokracisë, në të cilën ishin vendosur katër lloje të qeverive midis ekstremeve - oligarkia, mbretëria, aristokracia dhe forma e ligjshme e demokracisë. Mesi supozohej të arrihej përmes ekuilibrit të elementeve kushtetuese të cilat, të marra në vetvedte, do të ishin ekstreme. Më pas, Aristoteli “çliroi termat Platonikë nga kornizat e tyre teologjike, ontologjike, i vendosi ato në një sistem gjithëpërfshirës shkencor dhe u dha atyre një kalibër politikisht realist”.¹ Ai sugjeroi “politeia” si formën më të mirë të mundshme të qeverisjes, e cila përfaqëson një përzierje të elementeve “oligarkike” dhe “demokratike”. “Dydimensionaliteti ontologjikisht aksiologjik i mesoteve (mesi i artë) platonike-aristoteliane dhe doktrina kushtetuese mikse ofroi mundësi logjike për lidhje me taksonominë e re politike e cila u zhvillua pas Revolucionit Francez”.²

Dallimi midis dy formave, “ekstreme” dhe “e arsyeshme”, tani ishte lidhur me termat e rinj - “e djathta” dhe “e majta”.³ Në letërsinë bashkëkohore, ekstremizmi është ende i lidhur ngushtë me politikën dhe përfaqëson diçka që është “shumë përtej kufijve”.⁴ Për shembull, Pressman e përcakton atë si “çdo teori politike që mbështet politika ose ideologji të pa kompromis dhe të ngurta”.⁵ Duke pasur parasysh këtë, një ekstremist perceptohet si “dikush që ka mendime ekstreme, veçanërisht në politikë; në lidhje me masat ekstreme ose favorizimin e tyre”.⁶

1 Backes, U. (2007) Meaning and Forms of Political Extremism in Past and Present (Kuptimi dhe format e ekstremizmit politik në të kaluarën dhe të tashmen) . Rishikimi i Studimeve Politike të Evropës Qendrore. 9(4), fq. 242-262, fq. 243.

2 Ibid., fq. 244.

3 Ibid.

4 Pressman, D.E. (2009). Risk Assessment Decisions for Violent Political Extremism 2009-02. Ottawa, Ont.: Public Safety Canada, Backes, U. (2007). Meaning and Forms of Political Extremism in Past and Present. Central European Political Studies Review. 9(4), fq. 242-262.

5 Pressman, D.E. (2009). Risk Assessment Decisions for Violent Political Extremism 2009-02. Ottawa, Ont.: Public Safety Canada, fq. 5.

6 Qendra për Parandalimin e Radikalizimit që Çon në Dhunë (CPRL), në dispozicion në: <https://info-radical.org/en/>

Backes fokusohet në kategorinë e “ekstremit”, që së bashku me “ekstremizmin” është “diçka që është më e largëta”. Ai pretendon se “nuk ka asgjë përtej ekstremit; ekstremet nuk mund të rriten, ato mishërojnë diçka që nuk mund të tejkalohet ose kapërcehet”.⁷ Problemi i ekstremizmit bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në epokën e migrimit global dhe udhëtimeve të rregullta, pasi që “ndjenjat e përkatësisë” dhe të identitetit shpesh janë të copëzuara dhe aleancat personale mund të shkaktojnë konfuzion”.⁸

Ekzistojnë një sërë karakteristikash që mund të përdoren kur përshkruhet termi “ekstremizëm politik”, duke përcaktuar karakteristikat e tij të kundërta. Backes përdor këtë mënyrë të formësimit të termave nga aspekte të ndryshme në mënyrë që të përafrojë shpërndarjen e tyre politike dhe shoqërore:

1. *Pluralizmi në vend të monizmit.* Shteti bashkon një numër njerëzish, interesat dhe pikëpamjet e të cilëve janë të ndryshme, por në të njëjtën kohë legjitime.
2. *Orientimi drejt një të mire të përbashkët në vend të një ekzekutimi egotistik të interesave.* Nën kushtin e një “shumësie të te barabartësve”, duhet të merren parasysh interesa dhe botëkuptime të ndryshme.
3. *Sundimi i Ligjit në vend të qeverisjes arbitrare.* Një rend politik duhet të përbëhet nga rregulla të cilat duhet të respektohen nga të gjithë, përfshirë edhe ata që qeverisin për momentin.
4. *Vetëvendosja në vend të vendosjes nga jashtë.* Shumica dërmuese e vendimeve janë të pranueshme vetëm kur ekziston një mundësi e drejtë që të gjithë të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes.⁹

Duke pasur parasysh se ekstremizmi është ende shumë i pranishëm në shoqërinë moderne, pritet që ai të reflektojë tek popullata e re. *Një nga faktorët kryesorë që çon drejt ekstremizmit në mesin e popullatës së re është ekspozimi ndaj emocioneve negative dhe destruktive. Nëse ky faktor lidhet dhe pikëpreket me papunësinë dhe marginalizimin, individi ka predispozicion për të ushqyer pikëpamjet ekstremiste.*¹⁰

7 Backes, U. (2007). Meaning and Forms of Political Extremism in Past and Present. Central European Political Studies Review. 9(4), fq. 242-262, fq. 245.

8 Bashkimi Evropian (2005). Adresimi i faktorëve që kontribuojnë në radikalizimin e dhunshëm. Bruksel, Belgjikë: Këshilli i Bashkimit Evropian në lidhje me rekrutimin terrorist dhe komisioni, fq. 14.

9 Backes, U. (2007). Kuptimi dhe format e ekstremizmit politik në të kaluarën dhe të tashmen. Rishikimi i Studimeve Politike të Evropës Qendrore. 9(4), fq. 242-262, fq. 247.

10 Trebješanin, Ž. (2007). Psihologjia političkog ekstremizma. Beograd, Republika Srbija: Hereticus

Radikalizimi shpesh është i lidhur ngushtë me ekstremizmin. Radikalizmi i referohet dikujt që synon të përmbysë status quo-në, megjithatë jo shpesh domosdoshmërisht në një mënyrë të paligjshme ose të dhunshme. Kjo nënkupton që as radikalizmi dhe as ekstremizmi nuk çojnë automatikisht në kërcënime të sigurisë ose terrorizëm, prandaj është e rëndësishme të bëhet një dallim “midis radikalizmit dhe ekstremizmit si mënyra të menduarit nga njëra anë dhe sjelljeve të dhunshme nga ana tjetër”.¹¹ Duke pasur këtë në mendje *“proces përmes të cilit njerëzit adoptojnë një sistem të bindjeve ekstremiste - përfshirë qëllimin për të përdorur, inkurajuar ose lehtësuar dhunën – për të promovuar një ideologji, një projekt politik ose një kauzë si një mjet të transformimit social”*. Nga ana tjetër, radikalizimi që çon në ekstremizëm të dhunshëm është një “proces përmes të cilit një person pranon përdorimin e dhunës për të arritur qëllime politike, ideologjike ose fetare, përfshirë ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin”.¹² Radikalizimi është analizuar edhe nga Departamenti i Policisë së Nju Jorkut dhe u dalluan katër faza kryesore të këtij procesi:

1. *faza para radikalizimit, ose pika e origjinës;*
2. *faza e vetëidentifikimit - individët fillojnë të eksplorojnë ideologjinë radikale dhe të shoqërohen me individë të tjerë që kanë mënyrë të njëjtë të menduarit;*
3. *faza e indoktrinimit në të cilën bindjet intensifikohen dhe përforcohen;*
4. *sulmi ose faza terroriste - anëtarët pranojnë që është detyra e tyre të marrin pjesë në një sulm terrorist.*¹³

Jo të gjithë individët që fillojnë procesin e radikalizimit lëvizin nëpër të gjitha fazat dhe përfundojnë si terroristë.¹⁴ Dy fazat e fundit paraqesin sjellje që mund të përkufizohet si “radikalizim i dhunshëm”. Ky lloj radikalizimi është “procesi i adoptimit ose promovimit të një sistemi të bindjeve ekstreme me qëllim të lehtësimit të dhunës me bazë ideologjike për të avancuar ndryshimin politik, fetar ose shoqëror”.¹⁵ Radikalizimi që çon në terrorizëm është një proces dinamik në të cilin një individ gradualisht pranon dhunën terroriste si një mënyrë legjitime të veprimit.¹⁶

11 Weert, A. & Eijkman, Quirine. (2018). Subjectivity in detection of radicalisation and violent extremism: a youth worker's perspective. Shkencat Biheviorale të Terrorizmit dhe Agresionit Politik, f. 1-24, f. 192.

12 Qendra për Parandalimin e Radikalizimit që Çon në Dhunë (CPRL), në dispozicion në: <https://info-radical.org/en/>

13 Pressman, D.E. (2009). Risk Assessment Decisions for Violent Political Extremism 2009-02. Ottaëa, Ont.: Public Safety Canada, f. 4-5

14 Silber, M. D., & Bhatt, A. (2007). Radicalization in the èest: The homegroën threat. Nju Jork: Divizioni i Inteligjencës i Departamentit të Policisë së Nju Jorkut.

15 Pressman, D.E. (2009). Risk Assessment Decisions for Violent Political Extremism 2009-02. Ottaëa, Ont.: Public Safety Canada, f. 5

16 OEBS (2018). Roli i shoqërisë civile në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm. Viena: Austri, f. 7

2.2. Shtytësit e ekstremizmit të (dhunshëm)



Për të kuptuar ekstremizmin (e dhunshëm), duhet të përpiqemi të kuptojmë shtytësit e tij, ose me fjalë të tjera: cilat janë shkaqet ose arsyet që shpjegojnë pse grupet ose individët mund të joshen për të mbështetur ose për t'u angazhuar në ekstremizmin (e dhunshëm)¹⁷. Siç është e ditur, këtu kemi të bëjmë me fenomene të vështira dhe gjithnjë e më komplekse. Duhet të vëmë në pah që në fillim se literatura aktuale nuk identifikon ndonjë rrugë të qartë të vetme drejt radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Kështu, nuk ka një profil të vetëm të dikujt që do t'i bashkohet një grupi ekstremist të dhunshëm ose do të bëhet ekstremist i dhunshëm, pasi ka raste përgjatë të gjitha demografive, moshave, gjinive, statuseve socio-ekonomike, niveleve të arsimit, etj. Asnjë nga shtytësit nuk është i mjaftueshëm për të shpjeguar pse dikush u radikalizua, ose për të parashikuar që dikush do të radikalizohet, kështu që shtytësit nuk duhet të shihen individualisht ose si të ndarë, por gjithmonë si një kombinim kompleks dhe ndërveprim midis shumë faktorëve.

Për shembull, varfëria dhe mungesa e arsimit shpesh përmenden si faktorë, por nuk janë parashikues të mjaftueshëm. Shpjegimet që i referohen “kushteve themelore” janë të kufizuara për faktin e thjeshtë se “popullatat shumë të mëdha i përjetojnë ato dhe megjithatë, zakonisht, vetëm një pjesë e vogël e tyre i kthehen dhunës (...) shumica e atyre që preken nga kushtet themelore të cilave ekstremizmi i dhunshëm shpeshëherë i përshkruhet - në të vërtetë, nuk përqafojnë dhunën”¹⁸. Padyshim se kërkohen më shumë hulumtime sasiore dhe cilësore për shpjegime më të plota dhe të nuancuara. Prapëseprapë, duket se një “teori e përgjithshme” e ekstremizmit të dhunshëm nuk është e mundur, por çdo grup ekstremist ose manifestim i ekstremizmit të dhunshëm “duhet të shihet si produkt i një kombinimi të veçantë të variablave dhe dinamikave, që shfaqen në një moment të caktuar historik, në një mjedis specifik, dhe i formësuar nga kushtet lokale dhe dinamikat globale.”¹⁹ Prandaj, ekstremizmi i dhunshëm duhet të analizohet gjithmonë në një kontekst të veçantë, sepse arsyet dhe mënyrat do të ndryshojnë nga një mjedis në tjetrin.

Korniza më e përdorur është modeli i faktorëve “shtytës” dhe “tërheqës”, i zhvilluar nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)²⁰.

17 Leuven, D.V. (2019). Countering Violent Extremism: An Introductory Guide to Concepts, Programming, and Best Practices, Search for Common Ground.

18 Denoeux, G. and Carter, L. (2009). Guide to the Drivers of Violent Extremism, Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

19 Ibid.

20 USAID (2011). Reagimi Zhvillimor ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe rebelimit. Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), në dispozicion në: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pdacs400.pdf

1. Faktorët shtytës janë faktorë strukturorë që kontribuojnë në kushtet favorizuese të ekstremizmit të dhunshëm - ata janë të natyrës socio-ekonomike, politike dhe kulturore dhe perceptohen në nivelin individual ose të komunitetit. Në të njëjtin dokument, USAID rendit shembujt e mëposhtëm (duke vënë në dukje se nuk është një listë e plotë): 1. Nivele të larta të marginalizimit dhe fragmentimit shoqëror; 2. Zonat e qeverisura dobët ose jo të qeverisura; 3. Represioni qeveritar dhe shkeljet e të drejtave të njeriut; 4. Korrupsioni endemik dhe mosndëshkimi i elitave; 5. Perceptimet e kërcënimeve kulturore. Këta faktorë mund të jenë “çdo gjendje ose ankesë që krijon një ndjenjë frustrimi, marginalizimi dhe çfuqizimi, e cila inkurajon njerëzit të kërkojnë mjete korrigjuese duke përfshirë, por pa u kufizuar në, anëtarësimin në grupe ekstremiste”²¹.



Faktorët shtytës

1. Nivele të larta të marginalizimit dhe fragmentimit shoqëror;
2. Zonat e qeverisura dobët ose jo të qeverisura;
3. Represioni qeveritar dhe shkeljet e të drejtave të njeriut;
4. Korrupsioni endemik dhe mosndëshkimi i elitave;
5. Perceptimet e kërcënimeve kulturore.

2. Faktorët tërheqës janë kushtet që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi individin dhe përfshijnë shpërblimet psikosociale dhe / ose personale që joshin individët t'i bashkohen terrorizmit ose ekstremizmit të dhunshëm²². Disa shembuj të këtyre faktorëve përfshijnë: ndjenja e identitetit ose vetëvlerës ose përkatësisë; para ose stimuj ekonomikë; mbështetja për familjen e siguruar nga organizata terroriste; ndjenja e detyrës ose nderit ose heroizmit; ndjenja e fuqisë, aventurës ose dëshira për të ushtruar dhunë. USAID rendit shembujt vijues: 1. Qasje në burimet materiale, statusi shoqëror dhe respekti nga kolegët; 2. Ndjenja e përkatësisë, aventurës dhe vetëvlerësimit ose fuqizimi personal që individët dhe grupet që për një kohë të gjatë e kanë parë veten si të viktimizuar dhe të marginalizuar mund të rrjedhin nga ndjenja se po bëjnë histori; 3. Prospekti i arritjes së lavdisë dhe famës. Përveç këtyre të listuara, USAID gjithashtu vë në dukje si faktorë shtesë tërheqës këta si më poshtë: prania e institucioneve ose qoshkave radikale, ofrimin e shërbimeve nga grupet ekstremiste dhe përfshirjen ekstremiste në veprimtari të paligjshme ekonomike.

21 Slachmuisjlder, L. (2017). Transforming Violent Extremism: A peacebuilder's guide, 1st ed. Washington DC: Search for Common Ground.

22 Mattei, C. and Zeiger, S. (2018). Evaluate your CVE results: Projecting your impact. Hedayah, 2018.

Faktorët tërheqës



1. Qasje në burimet materiale, statusi shoqëror dhe respekti nga kolegët;
2. Ndjenja e përkatësisë, aventurës dhe vetëvlerësimit ose fuqizimi personal që individët dhe grupet që për një kohë të gjatë e kanë parë veten si të viktimizuar dhe të marginalizuar mund të rrjedhin nga ndjenja se po bëjnë histori;
3. Prospekti i arritjes së lavdisë dhe famës.

Promundo-US ofron një perspektivë gjinore, duke ekzaminuar lidhjet midis maskulinitetit dhe ekstremizmit të dhunshëm në një nga studimet e tyre të fundit²³. Ata marrin në konsideratë faktorët e mëposhtëm: 1. faktorët e nivelit individual (qëndrimet e dëmshme, historia e dhunës së partnerit intim, socializimi gjinor); 2. faktorët e nivelit të familjes dhe komunitetit (transmetimi ndërbrezor i dhunës, ndjenja e përfshirjes dhe përkatësisë); 3. faktorët e nivelit strukturor (varfëria dhe mungesa e mundësive kuptimplota, të arritshme; humbja e perceptuar dhe ndjenja e të qenit titullar; mungesa e besimit në institucionet publike; pamundësia për të shprehur mospajtimin; normat maskuline dhe militarizimi).

Brenda projektit YMI dhe komponentit të tij të Program Y +, organizata partnere Perpetuum Mobile nga Banja Luka, me Srđan Dušanić si hulumtues kryesor, zhvilloi një hulumtim sasior me një mostër prej 1058 të rinjve në të gjithë Bosnjën dhe Hercegovinën. Në studimin që rezultoi²⁴, Dušanić kreu një rishikim të gjerë dhe të plotë të burimeve të shumta. Lidhur me përcaktuesit e ekstremizmit, ai konkludon se: “Këta faktorë mund të kategorizohen afërsisht në individual, gruporë dhe shoqërorë. Përkundër disa pritjeve fillestare, parashikuesit më të fortë janë më tepër nga domeni grupor dhe shoqëror, sesa çrregullime të caktuara të personalitetit”. Gjithashtu theksohen fuqishëm përjetimet që bota është e padrejtë, veçanërisht ndaj fesë së tyre, njerëzve, shtetit ose ndaj ndonjë grupi tjetër shoqëror, si dhe disa ngjarje negative gjatë adoleshencës dhe ndikimit të grupeve të referencës si familja ose bashkëmoshatarët.

Rezultatet e hulumtimit sasior²⁵ të lartpërmendur tregojnë se rreth gjysma e të rinjve të anketuar nuk janë të kënaqur me shoqërinë në të cilën jetojnë, gjë që mund të jetë një predispozitë për zhvillimin e tendencave ekstremiste. Autori vë në dukje se rreth 15-20% e të rinjve të anketuar shprehën qëndrime ekstremiste, ndërsa 10-14% mbështesin ndonjë grup ekstremist ose madje kanë marrë pjesë në ndonjë veprim. Gjithashtu shqetësues është fakti që 45% e të rinjve u përgjigjën se do të

23 Sommers, M. (2019). Youth and the Field of Countering Violent Extremism. Washington, DC: Promundo-US, available at: <https://promundoglobal.org/resources/youth-and-the-field-of-countering-violent-extremism/>

24 Dušanić, S. (2020). Mladi i ekstremizam. Perpetuum mobile – Institut za razvoj mladih i zajednice, Banja Luka

25 Ibid.

mbështesnin veprimin radikal si një mjet për të ndryshuar gjendjen e punëve në shoqëri, ndërsa një në pesë të anketuar konsideronin ndonjë formë të angazhimit radikal. Studimi gjithashtu tregon se shumica e të anketuarve ndiejnë lidhje të forta etno-fetare dhe se baza e ideve ekstremiste kryesisht formësohet rreth këtyre identiteteve shoqërore. Të rinjtë që janë më të prirur ndaj ekstremizmit gjithashtu kishin tipare personaliteti më të theksuara të autoritarizmit, konservativizmit, tjetërsimit, antisociale dhe të triadës së errët²⁶. Ata janë gjithashtu më të "lidhur" me grupet e tyre kolegjiale (bashkëmoshatare) dhe socializimi i tyre ishte përgjithësisht më i ngarkuar nga përvojat negative.

Të intervistuarit në secilin prej vendeve të Ballkanit Perëndimor të vlerësuar në raportin e Forumit të Hulumtimeve të Ekstremizmit²⁷ theksuan "nevojën e ngutshme për të adresuar faktorët sistematikë si privimi ekonomik, korrupsioni dhe mosfunksionimi politik dhe institucional." Për më tepër, të anketuarit e të gjitha llojeve në të gjithë Ballkanin Perëndimor vënë në spikamë se nxitësi kryesor potencial i ekstremizmit është kriza e identitetit personal dhe në nivel të komunitetit, veçanërisht në mesin e të rinjve, të cilët përballen me nivele shumë të larta të papunësisë dhe të diskualifikimit shoqëror.

45 %



Të rinjtë/rejat do të mbështesnin veprimet radikale si mjete për të ndryshuar gjendjen e situatës në shoqëri



1 në 5

të anketuar konsideruan një formë të angazhimit radikal

Për ta përmbyllur këtë pjesë, duhet të nënvizojmë rëndësinë e të kuptuarit të kërcënimeve lokale të ekstremizmit të dhunshëm dhe shkaqeve të tij, sepse ekstremizmi duhet të vëzhgohet në një kontekst të veçantë. Zhvillimi i tij dhe faktorët ndryshojnë shumë nga konteksti në kontekst, kështu që programet e parandalimit (elementi kryesor i këtij rasti studimor) duhet të kontekstualizohen, bazuar në provat e mbledhura nga komunitetet lokale. Thjesht, nuk ka zgjidhje "e njëjta këmishë i vjen për shtat të gjithëve".

²⁶ Në psikologji, "triada e errët" përfshin tiparet e personalitetit të narcizmit, makiavelizmit dhe psikopatisë.

²⁷ Azinović, V. (2018). Forumi i Hulumtimeve të Ekstremizmit, Raporti Rajonal – Të Kuptuarit e Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkanin Perëndimor, Këshilli Britanik.

2.3. Metodologjia



Për të arritur objektivat e projektit dhe për të analizuar, përmbledhur dhe nxjerrë në pah sukseset, mësimet, mundësitë, aspekte të ndryshme dhe mangësitë në zbatimin e Programit Y + në vendet e shënjestruara, ekipi i konsulencës zhvilloi hulumtime në dy faza – hulumtime literature (desk research) dhe hulumtime cilësore.

Hulumtimet e literaturës përfshinin një përmbledhje të burimeve relevante (studime dhe artikuj) që kanë të bëjnë me ekstremizmin, radikalizimin dhe prirjen drejt terrorizmit në mesin e popullatës rinore. Kjo fazë e hulumtimit gjithashtu u përqendrua në një rishikim të kornizës legjislative në lidhje me çështjet kyçe të projektit. Ligjet, strategjitë dhe planet e veprimit u analizuan në nivelin e secilit shtet individual (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Kroaci dhe Serbi), nga kanë ardhur organizatat e përfshira në aktivitetet e projektit.


Gjatë fazës së hulumtimit cilësor, u zhvillua instrumenti hulumtues Udhëzues Intervistor. Ky udhëzues do të përdoret për të matur efektet e Programit Y + dhe mundësitë që ai ofron për anëtarët e ekipit të projektit, përfituesit dhe akterët e tjerë të rëndësishëm që morën pjesë në aktivitetet e lidhura me projektin.





**Rastet
studimore**

3. Rastet studimore



3.1. Angazhimi i komunitetit në procesin e parandalimit të radikalizimit të të rinjve/rejave



Vepro për Shoqërinë (VPSH) zhvilloi një model specifik, bazuar në nevojat e komunitetit lokal shqiptar, njësi administrative e Bërzhitës, e vendndodhur rreth 30 km nga Tirana, që mbledh së bashku të rinjtë (si brenda dhe jashtë shkollës), prindërit dhe mësuesit për t'i edukuar ata mbi tolerancën, barazinë gjinore dhe gjuhën e urrejtjes, si dhe shumë tema të tjera. Qasja e VPSH-së ndaj pilotit të Programit Y + përfshinte aktivitete të shumta: 1. Diskutime të Grupeve të Fokusit (DGF) me prindër, mësues dhe burra të rinjë dhe gra të reja, anëtarë/e të komunitetit. Këto DGF u përdorën për të përvijuar përvojat individuale dhe grupe në fushat e lidhura me projektin dhe pjesëmarrësit propozuan aktivitete të mëtejshme, të përdorura për dizajnimin e punësorëve; 2. Pyetësori me të rinjtë në rrezik dhe të rinjtë jashtëshkollorë. Përmes pyetësorit, anëtarët e komunitetit u pyetën për faktorët që i shtojnë studentët drejt sjelljeve ekstremiste / të dhunshme; 3. Dhjetë seminare u zhvilluan me rininë shkollorë dhe jashtëshkollorë, anëtarët e komunitetit dhe prindërit. Të gjithë pjesëmarrësit shkollorë dhe jashtëshkollorë ishin të moshave 17-22, dhe në fillim, kishte 76 pjesëmarrës shkollorë dhe 32 jashtë shkollorë. Në fund të aktiviteteve të projektit, rreth 15 të rinj jashtëshkollorë u larguan nga vendi - migruan ilegalisht ose u martuan (kryesisht në rastin e vajzave).



17-22

Mosha e pjesëmarrësve



76

Pjesëmarrësit
në shkolla



32

Pjesëmarrësit
jashtë shkollave

Zbatimi i programit Y + përfshinte aktivitetet e mëposhtme: 1. Modulet e trajnimit, bazuar në nevojat e vlerësuara nga studimi pikënisje, që mbulonin temat vijuese: “Komunikimi Strategjik dhe Zgjidhja e Problemeve për një Komunitet Tolerant” me të rinjtë në rrezik dhe “Shkathtësitë Psikosociale - se si mësuesit mund t'i përdorin ato në bashkëveprim me nxënësit” me mësuesit, gjithashtu aktivitetet përfshinin trajnimin “Fuqizo komunitetin” dhe punëtorinë për shkrim-leximin (edukimin) mediatik dhe gjuhën e urrejtjes; 2. Kampi Veror, i cili përfshinte pjesëmarrës nga programi Y + dhe

rini shkollore të rregullt të angazhuar në programe të tjera të AFS (VPSH). Gjithashtu u organizuan katër trajnime shtesë me të rinj dhe të reja, duke mbuluar tema specifike - komunikimi pozitiv për zgjidhjen tolerante të problemeve, rëndësia e edukimit të barazisë gjinore, turnetë për një komunitet më të mirë, toleranca për një komunitet më të shëndetshëm, etj; 3. Aktivitetet e kohës së lirë, ahengje të organizuara me animatorë, muzikë dhe gjëra të ngjashme, gjatë të cilave ata diskutuan për të drejtat e njeriut, të drejtat e të rinjve dhe të ngjashme. Këto aktivitete përfshinin pikturimin e gishtave në lidhje me barazinë gjinore, si dhe ditën ndërkombëtare të vajzave-rinisë dhe veprimeve publike.

Koordinatori i projektit shpjegoi se njësi administrative Bërzhitë u përzgjedh sepse ishte një komunitet rural shumë i mbyllur dhe tradicional, me banorë të një statusi të ulët socio-ekonomik dhe me mungesë mundësish për të rinjtë. Së pari, ekipi i projektit vendosi një bashkëpunim me shkollën e tyre të mesme, e cila i ndihmoi ata në procesin e rekrutimit të pjesëmarrësve. Nuk ishte e vështirë të arriheshin pjesëmarrësit jashtëshkollore, sepse shkolla siguroi një listë të ish-nxënësve dhe numrat e tyre të telefonit dhe i kontaktoi ata për të organizuar takime. Në këtë proces, ata u përballën me disa sfida, të tilla si çështjet motivacionale - në fillim, rinia jashtëshkollore nuk ishin shumë të interesuar të merrnin pjesë në aktivitete të lidhura me projektin.



Interesi i tyre, këndvështrimi i tyre është diçka që ndikoi më së shumti në atë nëse ata do të merrnin pjesë. Ata kishin qëndrimin e llojit 'pse duhet të jem këtu, kur nuk është e nevojshme, dhe unë do të largohem' - të gjithë ata provuan ndonjë lloj të migrimit ilegal. Vajzat po përpiqeshin të gjenin diçka tjetër, ishte më e vështirë për ato, familjet e tyre nuk i linin të dilnin nga shtëpia, përveç nëse ishte për shkollë ose një tubim familjar.

Eleni Nanaj, Koordinatore e projektit

Ata filluan të interesoheshin për këto tema kur kuptuan se ajo ishte “diçka ndryshe, diçka në lidhje me jetën e tyre personale ... ata e panë atë si diçka argëtuese dhe filluan të vijnë”, shpjegoi ajo.

Sfidat e programit kishin të bënin me metodologjinë e punëtorisë, pasi ekipi i projektit duhej të bënte përshtatje të caktuara - “ne duhej të përdornim një gjuhë krejtësisht të ndryshme dhe meqenëse ishte një komunitet mysliman, duhej të përdornim terma të ndryshëm, terma të tilla si seksi dhe gjinia nuk mund të përdorreshin... duhej të kishim kujdes që të mos fyejmë askënd”.

Sa i përket ndryshimeve të mundshme në qëndrimet dhe sjelljet e pjesëmarrësve, Koordinatorja e Projektit theksoi se ajo vuri re ndryshime të rëndësishme si tek prindërit ashtu edhe tek të rinjtë; “Prindërit nuk i lejuan vajzat e reja të dilnin për një kafe në mbrëmje me shoqet e tyre [në fillim të këtij programi] dhe deri në fund unë kisha 13 pjesëmarrës në kampin veror, kështu që tani të njëjtët

prindër faktikisht i lejuan ato të dalin. Ky është një ndryshim në mentalitetin e prindërve, ata janë më pak të rreptë dhe më mendjehapur”. Ata diskutuan për rëndësinë e arsimit, dhe disa prej tyre u regjistruan në kurse profesionale, të tilla si kurse për hidraulikë, elektrikistë dhe të ngjashme.

Gjatë intervistës në grup, ne gjithashtu biseduam me një nga prindërit e përfshirë në aktivitete të programit. Vajza e saj (e cila gjithashtu mori pjesë në projekt) e informoi atë për projektin dhe e motivoi atë për të marrë pjesë, pasi ajo dëshironte të bashkohej. Ajo e lejoi vajzën e saj të bashkohej me aktivitetet, duke thënë “po, sigurisht që mundesh dhe do të më tregosh gjithçka që po ndodh”.

Më interesantja për të ishte një diskutim i hapur rreth mentalitetit të komunitetit të tyre. Ajo theksoi se një dialog i hapur është i dobishëm si për prindërit ashtu edhe për të rinjtë, pasi të rinjtë dhe të rejat i perceptojnë prindërit si paksa tepër mbrojtës. Lidhur me këtë, ajo madje vuri re ndryshime të mëdha në komunikimin e saj me vajzën e saj - ato filluan të flasin më hapur. Nga ana tjetër, ajo thotë se aktivitetet e kohës së lirë ishin të panevojshme dhe merrnin shumë kohë. Ajo sugjeroi që aktivitetet e dizajnuara për prindërit mund të përfshijnë të rinjtë.

Një nga mësueset që morën pjesë në program tha se ajo dëgjoi për herë të parë për projektin nga drejtori i shkollës dhe ishte shumë e motivuar për të marrë pjesë, pasi kjo ishte “diçka e re për të gjithë ata, kjo ishte hera e parë që ata u qasën nga një OJQ”. Punëtoritë i lanë një përshtypje shumë pozitive dhe ajo besonte se nxënësit, së bashku me të gjithë të tjerët, vërtet i shijuan ato dhe ishin shumë të prirur për t’iu bashkuar që nga fillimi.



Temat e diskutuara ishin të rëndësishme për studentët për shkak të realitetit të komunitetit dhe asaj që po ndodh në botë në përgjithësi ... energjia e studentëve ishte e mahnitshme në ditët kur ata [ekipi i projektit] vinin dhe të kishin aktivitete... fëmijët i prisnin, ishin shumë të mërzitur kur ndonjë aktivitet anulohet.

Sidoqoftë, mësuesve nuk u lejohej të merrnin pjesë në seancat e punëtorisë me studentët, pasi “kjo do t’i ndalonte studentët të shpreheshin”. Ajo besonte se do të ishte shumë më mirë nëse mësuesit mund të ishin të pranishëm gjatë seancave, edhe pse ajo u foli atyre për to pas seancave. Ajo pohoi se u diskutuan tema të rëndësishme për komunitetin e tyre, të tilla si etiketimi, barazia gjinore, toleranca dhe zgjidhja e situatave të dhunshme – që ajo e konsideroi një gjë të mrekullueshme.

Të rinjtë u rekrutuan për Programin Y + nga përfaqësuesit e shkollës. Drejtori dhe mësuesit i kontaktuan ata individualisht, ose përmes prindërve të tyre, dhe ata u bashkuan nga kureshtja, pasi kjo ishte diçka që ata nuk kishin parë kurrë më herët, prandaj ata donin të provonin diçka të re.

Një pjesëmarrëse e re femër deklaroi në intervistë se më së shumti i pëlqente punëtoritë “Fuqizo komunitetin”, kur ata shkuan në qendër të qytetit për një trajnim dyditor. Kishte shumë të rinj dhe të reja dhe ata diskutuan për rindërtimin e qerdhes²⁸, tolerancën, etj. Ajo ceku se pas punëtorive ajo mund të ketë diskutime më të hapura me nënën e saj, kështu që komunikimi më i mirë ka një rëndësi të madhe për të. Nga ana tjetër, një pjesëmarrës i ri mashkull, tha se ai preferonte punëtoritë që kishin aktivitete loje rolesh dhe përfshinin zgjidhjen e situatave të dhunshme. Gjithashtu, aktivitetet e lojës me role në temat e barazisë gjinore dhe etiketimit ishte diçka që ata nuk e prisnin, por e shijuan shumë.

Koordinatorja e Projektit sugjeroi që aktivitetet e ardhshme duhet të përfshijnë më shumë aktivitete sportive, pasi ato mund të tërheqin vëmendjen e më shumë njerëzve, potencialisht atë të prindërve meshkuj. Ajo deklaroi se ekipi i projektit të VPSH është i gatshëm të vazhdojë të punojë me anëtarët e komunitetit, pasi ata krijuan një bashkëpunim të mirë. Sa i përket mësuesve, ajo sugjeroi që do të ishte e dobishme nëse mësuesit mund të merrnin pjesë në punëtoritë e të rinjve, sepse kjo do të hapte një dialog midis tyre. Të rinjtë dhe të rejat propozuan veprimtari të ngjashme, të tilla si organizimi i seancave të dialogut të hapur me mësuesit, si ato me prindërit, dhe prezantimi i aktiviteteve më praktike si, për shembull, garat sportive.

3.2. Qendrat për Punë Sociale si pika të komunitetit lokal për parandalimin e radikalizimit

Perpetuum Mobile (PM) zbatoi Programin Y + në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale (QPS) nga Banja Luka, Bosnjë dhe Hercegovinë (B&H). Programi përbëhej nga aktivitete të shumta: 1. Punëtori në Qendrën Ditore për të rinjtë / fëmijët në rrezik; 2. “Programi i pushimit të fundjavës”, i cili ishte një program pilot për parandalimin e sjelljes së dhunshme dhe antisociale tek të rinjtë në rrezik me përfituesit e QPS-ve. Programi pati rezultate të shkëlqyera dhe PM vazhdoi zbatimin e modaliteteve të tij të ndryshme, të tilla si “Pushimi i Dimrit” dhe “Pushimi i Verës” gjatë periudhës 2018-2020; 3. Organizimi i seminareve për punonjësit socialë nga entiteti i Republikës Srpska në Doboj, “Dhuna e bashkëmoshatarëve dhe promovimi i mënyrave të shëndosha të jetesës”, me qëllim për të shkëmbyer përvoja midis ekspertëve dhe praktikuesve; 4. Kërkime sasiore me 1,100 të rinj (18-19 vjeç), duke mbuluar të gjitha njësitë administrative në BeH, në mënyrë që të eksploroheh qëndrimet dhe sjelljet e të rinjve në lidhje me radikalizimin; 5. Promovimi i rezultateve të hulumtimit në tryezat e rrumbullakëta në Banja Llukë, Sarajevë dhe Doboj për 54 palë të interesuara, kryesisht nga sektori joqeveritar që merren me këtë çështje, si dhe studentë dhe profesorë. 6. Organizimi i një konference në Derventa me veteranë të luftës që përfaqësojnë popujt konstituivë të BeH-së, me qëllim diskutimin, adresimin dhe gjetjen e mbështetjes shtesë për trajtimin e ekstremizmit të të rinjve; 7. Organizimi i tryezave të rrumbullakëta me trupat diplomatike për të diskutuar radikalizimin dhe ekstremizmin si rezultat i kthimit të luftëtarëve nga jashtë.

28 Kur bëhet fjalë për rindërtimin e qerdhes, është e rëndësishme të theksohet se një grup të rinjsh drejtuan këtë projekt dhe morën fonde për zbatimin e tij, dhe se ata ishin të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e rindërtimit.

Intervista u zhvillua me ndihmën e një koordinatori nga PM dhe dy trajnerëve / të rinjve që morën pjesë në aktivitetet e projektit. Bazuar në gjetjet nga intervista, koordinatori arriti në përfundimin se është vendosur bashkëpunim me Qendrën e Kujdesit Ditor nga QPS Banja Llukë. Qendra e Kujdesit Ditor punon me të rinjtë në rrezik, dhe mënyra e vetme e mundshme për t'i arritur ata është vendosja e bashkëpunimit me QPS. Pilotimi u zbatua me një grup prej 24 djemsh dhe 19 vajza të reja gjatë tre muajve në 2019 në ambientet e Qendrës Ditore. Në bashkëpunim me QPS, programet u zhvilluan në përputhje me nevojat e të rinjve dhe bazuar në metodologjinë²⁹ e Programit Y dhe metodologjinë BOUNCE³⁰, si dhe rezultatet nga Qendra për Punë Sociale. Programi fillestar përfshinte 24 punëtori, tre aktivitete të kohës së lirë dhe tre programe të Pushimit të Fundjavës. Vlerësimi i pilotimit tremujor thekson se: "[Ai] programi është zbatuar me sukses me interesim të madh dhe përfshirjen e të rinjve në punëtoritë edukative të zhvilluara në Qendër." Rekomandon që aktivitetet e pilotuara duhet të zbatohen vazhdimisht në Qendrën Ditore.



Pjesëmarrësit e programit pilot

Programi i Pushimit të Fundjavës kishte një shtrirje të madhe në Banja Llukë, kështu që PM vendosi të vazhdojë me zbatimin e disa variacioneve të programit (Pushimi i Dimrit, Pushimi i Verës) për të ndikuar në qëndrimet dhe sjelljet e djemve të rinj të cilët treguan shenja të të qenit në rrezik të sjelljeve të dhunshme dhe radikalizimit. Programi bazohet në një qasje eksperienciale dhe kombinim të aktiviteteve të kohës së lirë dhe punëtorisë për djem të rinj të moshave 14-18 vjeç.


29 <https://youngmeninitiative.net/wp-content/uploads/2018/12/Y-TOOLKIT-ENG-WEB.pdf>

30 <https://www.bounce-resilience-tools.eu/home>

Njësitë tematike të pushimit të fundjavës:

1. Dhuna dhe situatat e konfliktit;
2. Alkooli dhe sjellja problematike që shkakton;
3. Të kuptuarit e hidhërimit dhe tërbimit dhe si të merremi me të;
4. Aftësitë negociuese dhe etiketimi i të tjerëve;
5. Menaxhimi i stresit dhe ndjenja e përkatësisë në shoqëri;
6. Radikalizimi dhe sjellja radikale.

Qasja e PM-së ishte jo vetëm për të punuar me të rinjtë në rrezik në Qendrën Ditore, por edhe për të ofruar mjete bashkëkohore për punonjësit socialë dhe për të ndërtuar aftësitë dhe njohuritë e tyre duke aplikuar të mësuarit përvojësor në të cilën të rinjtë inkurajohen të shqyrtojnë dhe analizojnë përvojat e tyre jetësore, të kërkojnë angazhim aktiv të pjesëmarrësve dhe qasjen kolegjiale. Qasja e PM-së ishte jo vetëm për të punuar me të rinjtë në rrezik në Qendrën Ditore, por edhe për të ofruar mjete bashkëkohore për punonjësit socialë dhe për të ndërtuar aftësitë dhe njohuritë e tyre duke aplikuar të mësuarit përvojësor në të cilën të rinjtë inkurajohen të shqyrtojnë dhe analizojnë përvojat e tyre jetësore, të kërkojnë angazhim aktiv të pjesëmarrësve dhe qasjen kolegjiale.



Si përgjigje ndaj pandemisë COVID- 19, në korrik 2020 u organizua “Programi i Pushimit Veror” në bashkëpunim me klubin “Bonu Burrë” të Banja Llukës që mbledhë bashkë të rinjtë me sjellje sfiduese, me qëllim që t’i ridrejtojë ata në iniciativat e komunitetit përmes mbështetjes bashkëmoshatarëshe. Prandaj, ata dolën me idenë që të rinjtë nga klubi “Bonu Burrë” të inkurajojnë bashkëmoshatarët e tyre që nuk kanë pasur kontakt me këtë program më parë t’i bashkohen aktiviteteve të tij dhe rreth 23 pjesëmarrës të rinj iu bashkuan. “Programi u ndoq nga të rinjtë lokalë nga lagjja, të cilët ishin paksa problematikë ose ishin në rrugë e sipër për t’u bërë problematikë - ata vizatuan grafiti, ishin tifozë sportivë, etj.” “Programi i pushimit veror” zgjati për tre ditë dhe përfshiu punëtori në lidhje me etiketimet, kënaqësitë dhe rreziqet, si dhe aktivitete të ndërtimit të ekipeve të tilla si sportet dhe rafting-u.

Siç theksoi koordinatori, ajo nuk do të ndryshonte asgjë në program. Sidoqoftë, përfshirja e të rinjve në rrezik nga Qendra Ditore ishte e pamundur në vitin 2020 për shkak të pandemisë që ka ndikuar në programim.



Nuk do të ndryshoja asgjë, mendoj se programi shkoi shumë mirë për sa na përket neve, mendoj se bëmë një punë të shkëlqyeshme, dëgjuam histori personale nga të rinjtë që i mbijetuan dhunës. Ky është rezultati më i mirë sepse ata u hapën, u bënë pjesë e klubit tonë dhe do të jenë në gjendje të promovojnë përvojat e tyre tek të rinjtë e tjerë.

Milica Jovičić, Koordinatore e Projektit

Trajnerët e intervistuar ishin fillimisht pjesëmarrës në program, të cilët më pas iu nënshtruan trajnimeve për t’u bërë edukatorë. Të dy trajnerët cekën se ata për herë të parë dëgjuan për PM, klubin “Bonu Burrë” dhe të gjithë programin, në shkollë. Të dy iu bashkuan rreth një vit më parë: “Meqenëse kisha shumë probleme në shkollë, kur dëgjova se ekziston një organizatë që merret me problemet e të rinjve dhe kundërshton dhunën, u interesova”.

Tema që iu interesoi numrit më të lartë të pjesëmarrësve ishte, sipas edukatorëve, rreziqet dhe kënaqësitë, e cila ishte tema e parë e Programit të Pushimit Veror dhe nxiti një diskutim aktiv. Veç kësaj, pjesëmarrësit i mirëpritën temat e tilla si ekstremizmi, etiketimi dhe pozita e burrave në epokën moderne. Të dy edukatorët pohojnë se temat që trajtojnë marrëdhëniet seksuale janë ende tabuja më e madhe dhe se askush nuk dëshiron të flasë për to.

Pjesëmarrësit thonë se ata kanë vërejtur ndryshime në qëndrimet dhe besimet si në vetvete ashtu edhe tek të tjerët. “Ndryshimi më i madh që ka ndodhur brenda programit është se edukatorët më kanë bërë të mendoj për disa tema, të mendoj pse diçka është ashtu siç është, si kemi ardhur deri

te kjo. Ky është ndryshimi më i madh për mua, tash unë interesohem më shumë për gjithçka.” Një pjesëmarrës tjetër ceku se “ata arritën të merrnin një përgjigje nga ne për diçka që ne as nuk e dinim se e dinim; në atë mënyrë ata ju motivojnë që në të vërtetë të shprehni mendimin tuaj”.

Shkaqet e qëndrimeve dhe sjelljeve ekstreme shoqërore tek të rinjtë

Për të mësuar më shumë rreth sjelljes ekstreme dhe asaj të radikalizuar, PM filloi të eksploroonte së bashku me ekspertë dhe praktikues. Ata së pari u konsultuan me QPS-të, pastaj mbledhën veteranët e luftës në Doboj për të shqyrtuar mënyrat më të mira për t'u përballur me ekstremizmin. PM gjithashtu organizoi konsultime me trupat diplomatike për të diskutuar ndikimin e kthimit të luftëtarëve të huaj.

PM kreu një hulumtim mbarëkombëtar që synon të eksplorojë prirjen e të rinjve ndaj qëndrimeve dhe sjelljeve ekstreme shoqërore, ku “ekstremizmi” nënkupton një gatishmëri për të përdorur metoda të dhunshme për të realizuar ndryshime të caktuara në një shoqëri që perceptohen si të padrejta ose të prishura moralisht. Moshë mesatare e pjesëmarrësve në hulumtim ishte 19.5 vjeç dhe ata vinin nga të gjitha rajonet në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Disa nga gjetjet kryesore tregojnë se rreth 15-20% e të rinjve shfaqin qëndrime të caktuara ekstremiste, ndërsa 7-14% në nivelin biheviotal mbështesin disa grupe ekstremiste ose madje kanë marrë pjesë në disa aktivitete. Përqindjet janë edhe më të larta për burrat e rinj.

Ky hulumtim është konvertuar në Monografinë “Rinia dhe Ekstremizmi” dhe paraqet një burim të vlefshëm në trajtimin e kësaj teme në Ballkan.

Në përgjithësi, gjatë zbatimit të aktiviteteve të lidhura me projektin, nuk kishte probleme të mëdha, përveç në fillim kur kishte vonesa në procedurat administrative për të marrë leje dhe për të vendosur bashkëpunim. Sidoqoftë, këto sfida u zgjidhën shpejt. Sot, institucionet (të tilla si QPS) e njohin PM si partner dhe pjesëmarrës të interesuar të rinjë aplikojnë me pëlqimin e tyre.

Sugjerimi i Perpetuum Mobile është që të organizohen më shumë ligjerata, të mbajtura nga ekspertë, në fazën tjetër të projektit. Ata dëgjuan një ligjeratë nga një profesor nga Fakulteti i Shkencave Politike që mbulonte tema të lidhura me projektin dhe edukoi pjesëmarrësit e rinj mbi to. Pjesëmarrësit u shprehën se, në këtë mënyrë, të gjithë (të përfshirë në aktivitete të projektit) do të jenë në gjendje të mësojnë më shumë rreth temave që diskutohen. Meqenëse të intervistuarit janë të kënaqur me zhvillimin e aktiviteteve të projektit, ata planifikojnë të vazhdojnë bashkëpunimin aktiv me QPS dhe aktivitetet e Programit të Pushimit Veror / Dimëror, pasi ato inkurajojnë të rinjtë të mësojnë më shumë rreth temave si ekstremizmi, etiketimi dhe të ngjashme.

3.3. Qendra e Paraburgimit për të Mitur si vend për risocializimin e të rinjve

Në vitin 2017, Status M nga Zagrebi, Kroaci, filloi zbatimin e Programit Y ndërsa punonte me kundërvajtësit e rinjë në Qendrën e Paraburgimit për të Mitur në Turopolje. Ata përfshinë tema të tilla si parandalimi i dhunës, barazia gjinore, mënyrat e shëndosha të jetesës dhe të ngjashme, dhe angazhimi i tyre atje ka treguar të jetë një aset i vlefshëm për të kuptuar se si rinia mund t'i bashkohet lëvizjeve ekstremiste dhe radikale. Status M bëri një raport vlerësimi mbi këtë temë, rezultatet e të cilit shërbyen si bazë për planin e veprimit për pilotimin e Programit Y +. Në vitin 2017, Qendra e Paraburgimit për të Mitur u zgjodh për pilotimin e modelit për adresimin e ekstremizmit rinor dhe ka rënë dakord të marrë pjesë në proces.

Pilotimi i Programit Y + filloi në korrik të vitit 2019, pas listës së propozuar të punëtorive dhe u krye nga trajnerët e Status M. Ata propozuan një program parandalimi duke përdorur disa tema të përfshira në Programin Y origjinal, të tilla si dhuna, etiketimi, aftësitë negociuese dhe të ngjashme, por ata gjithashtu shtuan tema të reja, të tilla si edukimi mediatik, lajmet e rreme, pjesëmarrja civile në politikë, ushtrimi i të drejtave civile dhe ligjore dhe punëtoritë për mendimin kritik. Programi i parandalimit përfshiu 11 punëtori me 10 deri në 15 burra të rinj të moshës 15-18 vjeç. Pas kësaj, ata organizuan një takim vlerësimi, i cili gjithashtu përfshiu aktivitete të kohës së lirë. Gjysma e pjesëmarrësve në program ishin burra të rinj romë. Gjatë aktiviteteve, trajnerët vlerësuan se grupi kishte nevojë për qasje tjetër për të mbuluar disa nga temat (mendimi kritik, demokracia) që ishin tepër abstrakte për ta. Prandaj, trajnerët vendosën për një qasje më pragmatike – ata modifikuan punëtoritë duke i përshtatur ato me nevojat specifike të pjesëmarrësve dhe filluan të shfaqin filma të zgjedhur me kujdes që mbulojnë tema të ekstremizmit, dhunës dhe ideologjive totalitare, por gjithashtu krijojnë hapësirë për zhvillimin e empatisë dhe mirëkuptimit. Pas shfaqjes së filmit, ata zhvilluan diskutime reflektimi për të nxitur mendimin kritik dhe empatinë.



15-18

vjeç



10 deri në 15

djemë të rinj



50%

njerëz të
komunitetit rom

Pjesëmarrësit

Programi i parandalimit

Intervista u zhvillua me koordinatorin e projektit nga organizata Status M (Tamara Tokić) dhe trajnerin i cili ishte i angazhuar në punëtoritë në Qendrën e Paraburgimit për të Mitur (Tin Frančić).³¹ Siç thanë ata, ekziston një traditë e gjatë e bashkëpunimit ndërmjet organizatave joqeveritare dhe institucioneve penale në Republikën e Kroacisë, pasi që “gjyqësori është mjaft i hapur ndaj OJQ-ve, kështu që nuk është aq e vështirë prë të hyrë brenda”. Me fjalë të tjera, OJQ-të lokale përfshihen në rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve në institucione të tilla. Ekziston një shërbim i trajtimit brenda institucionit që përbëhet nga punonjës socialë dhe psikologë, të cilët sugjerojnë pjesëmarrësit për punëtori dhe aktivitete të ngjashme.

Pengesa më e madhe gjatë aktiviteteve të programit (punëtorive) u shfaq për shkak të llojit specifik të grupit me të cilin është punuar. Ata deklaruan se:



Në aktivitetet që nuk i zhvilluam vetë [të cilat ata i kanë marrë nga burimet dytësore] kishte vështirësi, në fakt kjo qasje dhe këto tema u krijuan për nxënës të zakonshëm të shkollës së mesme... ky grup i të rinjve shpesh privohet në çdo mënyrë të mundshme, zhvillimore, materiale dhe edukative. Atyre u mungojnë gjërat themelore që shumica e fëmijëve i kanë gjatë rritjes.

Tin Frančić, Trajner

Për këtë arsye, ata vendosën të zgjedhin tema më bazike, për shembull ato që kanë të bëjnë me emocionet e pjesëmarrësve dhe marrëdhëniet e tyre të shëndosha/jo të shëndosha. Ata u përpoqën t'ia bënin këto tema thelbësore më të qarta atyre dhe t'i edukonin për këto çështje. Të intervistuarit besojnë se këto tema të lartpërmendura ishin parakusht për diskutimin e edukimit mediatik, demokracisë dhe temave të ngjashme. Sfida tjetër e rëndësishme ishte gjetja e një mënyre interaktive për të prezantuar temat gjatë punëtorive. Për shembull, punëtoritë për demokracinë (Demokracia 101) nuk ishin zgjidhja më e mirë, pasi pjesëmarrësit nuk ishin të gatshëm të diskutonin dhe të merrnin pjesë në to në mënyrë aktive. Nga ana tjetër, kishte edhe tema të tjera që ngjallën më shumë interes, si lajmet e rreme dhe edukimi mediatik. Gjithashtu, pjesëmarrësit e rinj e shijuan mjaft punëtorinë për marrëdhënie intime të shëndosha dhe jo të shëndosha. Gjatë kësaj punëtorie, trajnerët dhanë shembuj të asaj se “çfarë është sjellje e mirë” dhe “çfarë nuk është sjellje e mirë” në një marrëdhënie. Ata ishin mjaft të interesuar për këtë, kryesisht sepse ishin të mbyllur në një institucion dhe kështu nuk ishin në gjendje të krijonin këtë lloj marrëdhënieje.

31 Fillimisht, ishte planifikuar të kryeshin intervista edhe me kundërvajtësit e rinj nga Qendra e Paraburgimit për të Mitur në Turopolje, por ekipit të projektit i duhej pëlqimi nga Ministria, i cili do të zgjaste disa muaj dhe do të zgjaste aktivitetet, duke pasqyruar se është sezoni i pushimeve.



Nga ana tjetër, tema të tilla si edukimi mediatik ishin më të suksesshme. Ne shpalosëm këto tema në një mënyrë tjetër me ta, përmes filmave dhe diskutimeve të strukturuar. Ishte e qartë se këto tema ishin interesante për ta, veçanërisht ato që kishin të bënin me ekstremizmin, racizmin, neonazizmin dhe kulturën e skinheads që iu paraqitën atyre përmes filmave, të tillë si American History X.

Tamara Tokić, Koorditore e projektit

Përfaqësuesit e Status M besojnë se arritën t'u sqarojnë atyre dëshmërinë e atyre sjelljeve dhe mendimeve në një mënyrë adekuate, kryesisht përmes filmave, të cilët pjesëmarrësit shpesh preferonin.

Kur bëhet fjalë për këtë grup specifik të cenueshëm (kundërvajtësit e rinj), të intervistuarit mendojnë se ata janë shumë më të motivuar për të marrë pjesë në mënyrë aktive në punëtori dhe aktivitete të ngjashme në krahasim me studentët e rregullt të shkollës së mesme. Siç thanë ata, është shumë më e lehtë t'i motivojnë. Nxënësit e rregullt të shkollës së mesme nganjëherë i perceptojnë ata si profesorë dhe e përqafojnë qëndrimin e llojit "kur do të mbarojë kjo gjë e mërzitshme". Jeta e një nxënësi të zakonshëm të shkollës së mesme është shumë më dinamike sesa jeta e një kundërvajtësi të ri, i cili ndodhet në ndonjë lloj qendre të paraburgimit për të mitur, prandaj është më lehtë ta motivosh atë. Ata besojnë se ky grup është shumë i motivuar për të marrë pjesë në aktivitete pikërisht sepse dikush po u kushton vëmendje.



Na takon neve të gjejmë mënyra provokuese dhe interesante për t'i përfshirë ata në to [aktivitetet e punëtorisë], për shembull, t'i pyesim se si do të ishte nëse një vajzë fiton më shumë të ardhura se ata. Ata e konsideronin të pazakontë që dikush interesohej se çfarë mendojnë ata rreth diçkaje.

Tin Frančić, Trajner

Sidoqoftë, trajnerët vënë në dukje se megjithëse pjesëmarrësit janë ende të rinj, puna me ta mund të jetë shumë e rrezikshme; "Me ta gjërat mund të përshkallëzohen", duke çuar në një situatë shumë të pakëndshme dhe potencialisht të rrezikshme. Të intervistuarit vënë në dukje se vetëm trajnerët e trajnuar mirë duhet të punojnë me këtë popullatë.

Efektet e mundshme të punëtorive ishin të dukshme; trajnerët vunë re ndryshime në qëndrimet dhe sjelljen e pjesëmarrësve dhe se temat e përfshira në punëtori kanë ndikuar vërtet tek ata.

Lidhur me këtë, është e rëndësishme të përmendet se popullata rome është e pranishme në mënyrë disproporcionale në Qendrën e Paraburgimit për të Mitur në Turopolje; më shumë se gjysma e të burgosurve të saj janë rom. Ndryshimi në qëndrimet e tyre është i dukshëm në mënyrën se si ata e kuptojnë racizmin: për shembull, ata mësuan se është racizëm kur fyen romët për shkak të origjinës së tyre etnike. Në fund të aktiviteteve të projektit, burrat e rinj jo rom dhe ata rom filluan të uleshin së bashku; ata madje filluan të përqafohen dhe u bënë miq të ngushtë, ndonëse në fillim ata ishin plotësisht të distancuar.

Historia më interesante që intervistuesit tanë veçuan është se pjesëmarrësit e punëtorisë ishin shumë të gatshëm të tregonin hapur emocionet e tyre. Për shembull, shumica e tyre faktikisht kanë përgatitur poezi, këngë dashurie, të cilat i lexojnë gjatë punëtorive. Ata nuk ndiheshin në siklet, gjë që ishte e pazakontë për rininë në moshën e tyre. Gjithashtu, ishte një djalë i cili kishte një jetë vërtet të vështirë, madje kishte bërë një svastikë të tatuazhuar në qafë, i cili në fund “doli të ishte si një fëmijë, ai ndryshoi totalisht”, siç na tha trajneri i Status M.

Meqenëse OJQ-të në Republikën e Kroacisë kanë një traditë të gjatë të bashkëpunimit me Qendrat e Paraburgimit dhe burgjet, ekipi i projektit Status M planifikon të vazhdojë të punojë me kategori të cënueshme të të rinjve, ato që ata kanë arritur tashmë në Qendrën e Paraburgimit për të Mitur në Turopolje. Ata e konsiderojnë të rëndësishme të diskutojnë tema të tilla si dhuna, etiketimi, pjesëmarrja civile dhe të drejtat civile me ta, në mënyrë që të kontribuojnë në risocializimin e të burgosurve në këtë qendër.

3.4. Angazhimi i palëve të interesuara dhe të rinjve lokal në parandalimin e ekstremizmit të të rinjve

Pilotimi i Programit Y + në Kosovë u zbatua nga organizata SIT në komunën e Podujevës, e cila ndodhet rreth 35 kilometra në veri të Prishtinës. Statusi i ulët socio-ekonomik i shumicës së popullsisë kryesisht rurale, mungesa e arsimit, mundësive dhe aktiviteteve për të rinjtë, si dhe mungesa e plotë e programeve të ngjashme arsimore, ishin arsyt pse SIT zgjodhi Podujevën si një lokacion të synuar. Programi përbëhej nga: 1. Hulumtimi pikënisje me rekomandime që shërbyen si bazë për ndërhyrjen e programit; 2. Trajnime dhe punëtori të vazhdueshme me grupin e të rinjve të përbërë nga nxënës të shkollës së mesme dhe rinia jashtëshkollore, me qëllim rritjen e reziliencës së të rinjve, duke parandaluar kështu radikalizimin dhe qëndrimet dhe sjelljen ekstreme. Aktivitetet arsimore fillimisht u bënë me prani fizike dhe më vonë përmes platformës Zoom, për shkak të krizës me COVID-19; 3. Trajnime për mësuesit e shkollave të mesme mbi çështjet e dhunës, ekstremizmit dhe radikalizimit; 4. Takime shitesë me të njëjtët pjesëmarrës të rinj, gjithashtu së pari me prani fizike dhe më vonë online, me qëllim të diskutimit të mëtejshëm të këtyre temave në një mënyrë më joformale, duke folur për jetën e tyre, sfidat dhe çështjet me të cilat ata përballen.

Programi filloi me hulumtimin bazë të kryer në Podujevë, i përbërë nga pesë fokus grupe (FG) me akterë të ndryshëm lokalë - punonjës socialë, gjykatës, prokurorë, përfaqësues fetarë, polici lokale, media,

mësues të shkollave të mesme, nxënës dhe prindër. Mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimit brenda trekëndëshit nxënës-mësues-prind u identifikua nga shumica e pjesëmarrësve si një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e sjelljes ekstreme dhe të dhunshme. Ky është veçanërisht problemi në rastet e nxënësve që janë përjashtuar nga shkollat e mesme për shkak të sjelljes delikuate - ata nuk mund ta komunikojnë këtë me prindërit e tyre, ata janë lënë pas, dhe kështu konsiderohen të rrezikuar nga radikalizimi. Gjithashtu, mësuesit u shprehën se nuk ndihen mjaftueshëm kompetentë për t'u marrë me rastet e sjelljes problematike midis nxënësve të tyre. Nxënësit e shkollave të mesme veçanërisht vunë re se ata përfshihen në konflikte për shkak të paaftësisë së tyre për të kontrolluar emocionet impulsive.

Pas vendosjes së bashkëpunimit me vetëqeverisjen lokale dhe shkollën e mesme "Isa Boletini", pilotimi i programit filloi me nxënës të përzgjedhur (25 gjithsej), mësues (17) dhe të rinj jashtëshkollorë (6). Krijimi i bashkëpunimit me Departamentin për Punë Sociale, shkollën e mesme, prindërit, si dhe me policinë, dëshmuar të jenë shumë të dobishme për arritjen e të rinjve jashtëshkollorë. Megjithatë, në fillim sfida më e madhe ishte angazhimi dhe motivimi i të rinjve jashtëshkollorë. Ata nuk dëshironin të merrnin pjesë në fillim, por pas disa ditësh dëgjuan gjëra të mira në lidhje me programin dhe me dëshirë iu afruan staftit të SIT për t'iu bashkuar punëtorive. Programi arsimor përbëhej nga punëtori të përshtatura nga manuali i Programit Y³² ("Shprehja e emocioneve", "Çfarë të bëj kur jam i hidhëruar?", "Çfarë është dhuna?", "Nderi mashkullor", "Të kuptuarit e ciklit të dhunës", "Etiketimi", "Pushteti dhe marrëdhëniet", "Aftësitë negociuese", etj.) me shanca shtesë që vënë theks të veçantë mbi mënyrat pozitive të trajtimit dhe kontrollit të emocioneve dhe sjelljeve të dëmshme (e cila ndikon në shëndetin mendor pozitiv), si dhe të mësuarit e aftësive të mira të komunikimit. Gjatë zbatimit, të rinjtë jashtëshkollorë u integruan me nxënës të shkollave të mesme në një grup, e që lehtësoi ndjenjën e segregacionit dhe nxiti shoqërimin dhe unitetin midis të rinjve.



25
nxënës/e



17
mësimdhënës/e




6
të rinj/reja jashtë
shkollave

Profili

i pjesëmarrësve

32 Në dispozicion në faqen e internetit të YMI: <https://beta.youngmeninitiative.net/ëp-content/uploads/2017/07/Program-Y-ENG.pdf>

Bashkëpunimi i implementuar vërtetoi të ishte shumë i dobishëm për të arritur të rinj dhe të reja në shkolla



Në një intervistë në grup, të gjithë pjesëmarrësit e rinj u shprehën shumë të kënaqur me programin, dhe thanë se ishin shumë të interesuar në temat që lidhen me shprehjen e emocioneve të tyre, diskriminimin mbi baza të ndryshme, veçanërisht në marrëdhëniet gjinore, si dhe ato që lidhen me (pa) barazinë gjinore. Aktivitetet e llojit “lojë rolesh” brenda punëtorive ishin qartazi të preferuarat e të rinjve. Pjesëmarrësit gjithashtu deklaruan se ndiheshin të sigurt dhe të mbështetur në këtë mjedis dhe se ishin të kënaqur që grupi miks punoi mirë së bashku. Të gjithë të intervistuarit thanë se kjo ishte hera e parë që ata hasnin një program që mbulon këto lloj temash në komunën e tyre dhe se mendonin që ishte diçka krejtësisht e re dhe interesante, e cila bëri që ata ta vlerësonin edhe më shumë.



Kam ndryshuar shumë qëndrime dhe sjellje që i kisha para se të hyja në këtë program, kryesisht në lidhje me diskriminimin e të tjerëve, veçanërisht të vajzave dhe grave. Në mjedisin tim më të ngushtë konsiderohet praktikisht normale të diskriminosh, dhe pjesa më e madhe e diskriminimit vjen nga djemtë dhe burrat. Programi i ka sfiduar këto qëndrime dhe më ka bërë të rimendoj dhe të ndryshoj, dhe të arrij një të kuptuar shumë më të mirë.

Rron Rama, pjesëmarrës i ri mashkull

Promovimi i singleritetit, ndershmërisë dhe respektit të përgjithshëm për të gjithë, të cilat janë vlerat që përfaqësojnë shtyllat e këtij programi, duket se ndikojnë te disa pjesëmarrës, duke rritur aftësitë e tyre të komunikimit dhe vetëbesimin dhe duke i bërë ata më mendjehapur në proces.



Kam mësuar shumë rreth shprehjes së emocioneve, gjithashtu për temat mbi diskriminimin dhe barazinë gjinore. U bëra më e hapur ndaj njerëzve të tjerë dhe i konsideroj të gjithë si të barabartë. Tani është më e lehtë për mua të flas para të tjerëve, para një grupi të njerëzve, kam më shumë vetëvlerësim dhe vetëbesim.

Erisa Azemi, nxënëse, pjesëmarrëse femër

Mësuesi Agron Hyseni, një tjetër i intervistuar, shprehu kënaqësinë që mori pjesë në trajnimin për mësuesit, si dhe u shpreh i kënaqur me programin që po zbatohet në shkollën e tij të mesme, pasi nuk kishte programe të ngjashme askund në Podujevë më parë. Ndryshimi në qëndrimin e pjesëmarrësve të programit është i dukshëm, pasi sjellja e të rinjve ka ndryshuar për të mirë, duke vënë në dukje shembullin e nxënësve që tani po mendojnë më kritikisht pse dhe si sillen. Ai dhe koordinatori i projektit Kadri Gashi, të dy pajtohen se i gjithë komuniteti mund të përfitojë nga ky program, dhe që duhet të përfshijë më shumë nxënës dhe mësues në këtë shkollë, por edhe në shkolla dhe komunitete të tjera, me palët e tjera të interesit.

Zbatimi i Programit Y+ për fat të keq u ndërpre për shkak se pandemia COVID-19 ndërhyri në planet e SIT për të organizuar trajnime për palët e interesit (prokurorë, gjyqtarë, punonjës socialë, polici dhe media), aktivitete me prindër, takime për reflektim dhe vlerësim. Sidoqoftë, programi arsimor me të rinjtë vazhdoi me sukses në internet përmes platformës Zoom. Nëse koha dhe situata pandemike lejojnë, SIT do të kryejë aktivitetet e mbetura deri në fund të projektit, ose do të përpiqet të zbatojë një qasje online me palët e interesit të lartpërmendura. Koordinatori i projektit gjithashtu vuri në dukje se programi mund të zgjerohet më tej në përpjekjet e ardhshme për të siguruar qëndrueshmëri. Një rekomandim tjetër ishte të lejohej një kornizë më e gjatë kohore e zbatimit, veçanërisht duke marrë parasysh ndjeshmërinë e temave të tilla si radikalizimi dhe ekstremizmi.

3.5. Edukimi me bazë në teatër si përgjigje ndaj çështjeve të ekstremizmit në zhvillim

Qendra E8, një organizatë rinore nga Beogradi, Serbi, përdori teatrin edukativ si një mjet për të trajtuar çështjet e ekstremizmit, dhunës dhe radikalizimit në mesin e të rinjve. Edukimi i bazuar në teatër dhe zhvillimi i shfaqjeve teatrore të angazhuara shoqërisht është një nga pikat e forta kryesore të E8, pasi ata kanë gati një dekadë përvojë në përdorimin e metodave të tilla, me shumë suksese dhe rezultate pozitive. Puna e Qendrës E8 në Programin Y + mund të diferencohet, në mënyrë kronologjike dhe programore, në dy pjesë. Pjesa e parë përbëhej nga: 1. Zhvillimi i një programi të ri edukativ për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit, i pilotuar gjatë seancave trajnuese treditore në tre qytete në Serbi - Novi Pazar, Vranjë dhe Krushevc; 2. Klubet “Bonu Burrë” të formuar nga pjesëmarrësit e trajnimit të cilët më pas organizuan veprime publike në komunitetet e tyre lokale. Pjesa e dytë përbëhej nga: 1. Hulumtimi bazë cilësor; 2. Zhvillimi i një shfaqje teatrore që trajton çështjet e radikalizimit dhe ekstremizmit; 3. Shfaqjet teatrore që synojnë të rinjtë në të gjithë Serbinë; 4. Konferenca dhe ngjarje që synojnë palët e interesit.

Në “pjesën e parë” të lartpërmendur, Qendra E8 ndërmori një qasje më konvencionale. Rreth gjysma e programit edukativ përbëhej nga punëtori të përditësuar nga Programi Y, ndërsa gjysma tjetër kishte punëtori që hulumtonin tema të reja si: identiteti, përkatësia në grupe, llojet dhe shkathtësitë e komunikimit, dhuna digjitale (me theks në rreziqet e rekrutimit online nga grupe ekstremiste). Këto trajnime u pasuan nga metoda tashmë e provuar dhe e testuar “Klubi Bonu Burrë”, në të cilën anëtarët e të rinjve organizuan veprime publike që synonin zgjerimin e shtrirjes së mesazheve dhe vlerave të tyre pozitive. Më e dukshme ishte krijimi i dy muraleve të mëdha me mesazhe të drejtpërdrejta dhe të qarta kundër dhunës, diskriminimit dhe ekstremizmit, të dyja të bëra në muret e shkollave të mesme, duke siguruar dukshmërinë e tyre për të gjithë nxënësit dhe shumë qytetarë të tjerë.

Sa i përket “pjesës së dytë”, duhet të theksojmë se njëra nga pikat kryesore të forta të Qendrës E8 është programi i saj i teatrit dhe përvoja e madhe në zhvillimin e shfaqjeve teatrore të angazhuara shoqërisht, që nga krijimi i “Macho Men” në 2012 si pjesë e YMI. Kështu, brenda projektit aktual, për E8 u duk logjike, por edhe kreative, të përdoren metodat e teatrit në edukim për të trajtuar çështjet komplekse të radikalizimit dhe ekstremizmit. Procesi i zhvillimit filloi me një audicion për aktorë/aktore, ku u zgjodhën dy burra të rinj dhe dy gra të reja. Këta të rinj shumë shpejt u bënë jo vetëm aktorë, por edhe bashkautorë, pasi historitë e tyre personale kishin një rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e shfaqjes.

Së shpejti do të zbatohet punësia e të mësuarit dhe veprimit participator (PLA) në Novi Sad, me nxënës nga shkolla të mesme të ndryshme. PLA është një lloj i hulumtimit cilësor ku, përmes punësive dhe metodave të ndryshme, hulumtuesi fiton njohuri të thella të problemit. Kjo PLA shërbeu si hulumtim bazë, si dhe metodë për mbledhjen e përvojave dhe qëndrimeve të të rinjve, duke infuzuar drejtpërdrejt procesin e zhvillimit.

Në dhjetor të vitit 2018, shfaqja “EXTREMIZMI: Si t’ia shpjegoj këtë djalit tim?” u shfaq premierë në Novi Sad, e cila u pasua shpejt nga një tjetër premierë në Beograd, të dyja me një auditor të plotë në pothuajse të gjitha 12 shfaqjet në tetë qytete deri më tani. Jashtë Serbisë, shfaqja u dha në Banja Llukë, në bashkëpunim me partnerin e YMI-së Perpetuum Mobile. Shfaqja shënjestron të rinjtë por i flet edhe të rriturve. U bënë marrëveshje me disa shkolla të mesme dhe një fakultet për shkuarje të përbashkëta të organizuara për të parë shfaqjen.

Shfaqja në përgjithësi ngjalli reagime shumë pozitive si nga kritikët ashtu edhe nga publiku, të cilët kryesisht e përshkruajtën atë si shumë prekëse, intensive dhe që të ngjall mendime. Duket se është me vend që një shfaqje teatrale mbi ekstremizmin është paksa ekstreme. Është provokuese, pa kompromis, ndonjëherë zbavitëse, ndonjëherë tmerruese, por në fund të fundit shumë emocionuese. Nuk ka dyshim që të gjithë ata që e shohin largohen nga teatri me një përshtypje të fortë dhe reagim emocional. Sa i përket ndikimit të shfaqjes, duket qartë - nëse dikush mund të preket nga shfaqja, ai person mund të ndryshohet ose të ndikohet nga shfaqja, e cila funksionon si në nivelin emocional ashtu edhe në atë konjitiv. Për sa i përket reagimeve negative, kemi dëgjuar që gjatë performancës në Novi Sad disa njerëz u larguan nga publiku dhe se disa fishkëllyen gjatë pjesës kur iu bë referencë Luftës së Bosnjës të vitit 1990, duke treguar përsëri se disa “plagë janë ende të freskëta”, pasi që këta njerëz ishin refugjatë nga BeH, sipas aktorit Dejan Maksimović. Sidoqoftë, nuk pati ndonjë reagim të ngjashëm ndaj shfaqjes në Banja Llukë dhe aktori që intervistua e konsideron atë interpretimin e tij të preferuar. Përveç aktorit, ne gjithashtu folëm me drejtorin e teatrit/Qendrës E8 Vojislav Arsić dhe dy pjesëmarrës të rinj në lidhje me përshtypjet dhe mendimet e tyre.



Kjo shfaqje patjetër që lë përshtypje dhe ju prek. Duket se i bën të gjithë të mendojnë pasi të mbarojë dhe të gjithë kanë diçka për të thënë, kështu që duhet të organizohet një diskutim. Pjesa e shfaqjes që më tronditi më shumë ishte pjesa kur aktorët japin shembuj nga jeta e tyre, nga e kaluara kur kishin paragjykime, në lidhje me momentet gjatë të cilave ata ishin një lloj 'mini-ekstremistësh' dhe nuk ishin me të vërtetë të drejtë me njerëzit në rrethinat e tyre [romët, personat e pastrehë, etj.]

Jana Šarić, pjesëmarrëse e re femër



Shfaqja më pëlqeu, flet për gjëra që nuk mund t'i dëgjojmë askund, padyshim jo në biseda me miq dhe bashkëmoshatarë, gjëra që duhen prezantuar në një shfaqje apo film në teatër. Më ndihmoi të kuptoj më mirë ekstremizmin dhe më dha më shumë mënyra për t'ua shpjeguar të tjerëve. Unë mendoj se diskutimet pas shfaqjes do të ishin të mira, për të trajtuar më shumë çështjet, pasi disa njerëz mund të kenë akoma ankesa, për shembull të rinjtë që njoh prindërit dhe familjet e të cilëve ishin refugjatë nga Kroacia.

Nikola Vasić, pjesëmarrës i ri mashkull

Në përgjithësi, të intervistuarit rekomandojnë organizimin e diskutimeve me audiencën menjëherë pas shfaqjes. Njëri nga aktorët vuri në dukje se i pëlqejnë biseda të tilla me një audiencë të rregullt rinore, po aq sa i shijon gjatë fazës së përgatitjes. Një pjesëmarrës i ri rekomandon gjithashtu krijimin e videoklipeve që tregojnë shembuj të ekstremizmit, të cilat mund të përdoren për të filluar diskutimet gjatë punëtorive. Regjisori rekomandon që të zhvillohet më tej Y + dhe të përdoren metodat e teatrit në projektin e ri, p.sh., për të krijuar seanca teatri forumi, si një lloj imitimi i kësaj shfaqjeje. Pandemia e koronavirusit pengoi shumë plane për dhënien e shfaqjes këtë vit, por në momentin e shkrimit të kësaj, një shfaqje është planifikuar për në shtator 2020. Regjisori na tha që shfaqja do të vazhdojë të shfaqet mirë pasi të ketë përfunduar ky projekt. Gjithashtu, nëse situata me epidemi vazhdon, ekipi është i gatshëm të konceptojë dhe zhvillojë disa mënyra alternative për të arritur një audiencë, përmes platformave online.

Lidhur me përfshirjen e palëve të interesit, veçanërisht domethënëse ishte konferenca MAN2019 e Qendrës E8, e cila iu kushtua plotësisht temave të ekstremizmit të të rinjve dhe parandalimit të tij. Shfaqja teatrale u performua gjatë hapjes së konferencës, së bashku me fjalimet kryesore dhe diskutimin në panel me ekspertë ndërkombëtarë. Gjithashtu, një panel diskutimi në konferencën MAN2020 trajtoi temat e ekstremizmit. Qendra E8 gjithashtu ka prezantuar punën e tyre të Programit Y + si një shembull i praktikës së mirë në një konferencë kushtuar kësaj teme, organizuar nga Zyra për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, e cila mblodhi përfaqësues të të gjitha ministrive qeveritare të përfshira në parandalimin e ekstremizmit.

*Iniciativa e
Burrave*

*te Rin
Baraz*

**Konsideratat
përfundimtare dhe
rekomandimet**



4. Konsideratat përfundimtare dhe rekomandimet

Ky kapitull diskuton shkurtimisht disa reflektime mbi pilotimin e Programit Y + dhe ofron disa rekomandime për zbatimin e ardhshëm të këtij programi brenda projektit rajonal të YMI.



1. Programi Y + si një program unik rajonal për të rinjtë/rejat

Duke pasur njohuritë dhe “kujtesën institucionale të YMI” në lidhje me procesin e zhvillimit dhe shumë arritje yjore të Programeve M dhe Y, duhet të pyesim veten - a mundet që Programi Y + të ndjekë rrugën e ngjashme të zhvillimit, në një farë mase? Me fjalë të tjera, kur shqyrtojmë se çfarë do të ishte e dobishme për të ardhmen e Programit Y + brenda kornizës së YMI, ne rekomandojmë zhvillimin e një programi gjysmë të standardizuar Y + dhe manualin e tij që do të përdoret në të gjitha vendet me potencial shkallëzimi. Ne përdorim prefiksën “gjysmë” për të treguar se standardizimi i plotë nuk do të ishte një ide e mirë, dhe në fakt nuk do të ishte as e mundur. Këtu duhet të kemi parasysh se:

- a. Standardizimi ofron: sigurim më të besueshëm të cilësisë, përpjekje më të fokusuara, tregues dhe rezultate më të besueshme, planifikim dhe shpërndarje më të lehtë, dhe natyrisht një mjet të vlefshëm për praktikuesit;
- b. Do të ishte mirë nëse programi do të kontekstualizohej, përshtatur për komunitetet specifike lokale dhe karakteristikat e tyre përkatëse, ndërsa do të merreshin parasysh ndërthurjet ndërmjet faktorëve në nivele të ndryshme. Kjo mund të arrihet duke e ndarë programin (dhe manualin) në dy pjesë - pjesa e parë do të ishte më universale, dhe pjesa e dytë do të ishte më specifike.

Organizatat partnere kishin një nivel të konsiderueshëm të lirisë dhe punuan të pavarur në konceptimin dhe zhvillimin e programeve të tyre Y + në këtë fazë. Kur vëzhgohet se çfarë është bërë dhe çfarë kanë përfshirë në punën e tyre, mund të vërehen tema të përbashkëta. Praktikisht të gjithë partnerët punuan në: përmirësimin e mendimit kritik midis pjesëmarrësve; eliminimin e paragjytimeve dhe stereotipave, parandalimin e etiketimeve dhe diskriminimit; mësimin e pjesëmarrësve se si të merren me emocionet, nxitjen e ndjeshmërisë dhe përmirësimin e higjienës së tyre të shëndetit mendor; përmirësimin e aftësive të tyre të komunikimit dhe ndihmimit të tyre për të gjetur mënyra për të negociuar dhe zgjidhur problemet në mënyrë paqësore; edukimin e tyre mbi lajmet e rreme dhe ndikimin e mediave dhe rrjeteve të mediave sociale (pasi ato janë kanale bashkëkohore të indoktrinimit dhe mjete për rekrutimin); promovimin e të drejtave të njeriut dhe aktivizmin bazuar në të drejtat e njeriut; sfidimin e normave gjinore dhe stereotipeve; etj.

Këto, si dhe temat e tjera të ngjashme, duhet të jenë themeli i programit të ri, pjesa e tij e parë dhe universale, pasi nuk është rastësi që partnerët zgjedhën këto tema të veçanta. Në të ardhmen, ekipi i YMI mund të organizojë një lloj grupi punues që do të mbledhë gjatë disa ditëve. Ky mund të jetë fillimi i një procesi zhvillimi, kështu që ata mund të shohin se çfarë kanë të përbashkët, çfarë funksionon, çfarë duhet bërë, etj. Ekspertët e jashtëm mund të bashkohen me grupin dhe/ose të ndihmojnë procesin në të cilin të gjithë partnerët (koordinatorët e tyre, trajnerët dhe pjesëmarrësit e rinj) do të diskutojnë dhe të bien dakord mbi temat që duhet të mbulohen në të ardhmen nga të gjithë, dhe si duhet të bëhet kjo - çfarë punëtori, metoda, aktivitete. Përmes punës së përqendruar, produktive dhe kreative, ky grup mund të krijojë punëtori dhe aktivitete të shkëlqyera, duke përdorur përvojën e tyre të vlefshme të fituar gjatë zbatimit të Y +.

Grupi gjithashtu do të punonte në pjesën e dytë të programit/manualit, atë më specifik. Në lidhje me këtë, ata do të diskutojnë dhe theksojnë specifikat e grupeve të ndryshme të të rinjve në vendin e tyre, do të vendosnin për punëtoritë/aktivitetet specifike (që funksionojnë në kontekstin e tyre, por jo domosdoshmërisht në ndonjë tjetër), duke krijuar kështu seanca specifike që nuk do të ishin “të detyrueshme” për të gjithë partnerët. Do të ishte mirë nëse seancat specifike do të përfshiheshin në manual, si një opsion për të tjerët (gjithashtu për të tjerët jashtë YMI). Kjo pjesë e programit/manualit do të ishte padyshim më pak uniforme, dhe përveç punëtorive edukative mund të përfshijë gjithashtu rekomandime, ide dhe përshkrime të aktiviteteve shitesë që janë argëtuese dhe edukative; për shembull, lojëra dhe aktivitete në natyrë, ekskursione, vizita, shfaqje teatrore, shfaqje filmash, veprime publike nëse është e përshtatshme për grupe të veçanta, ide për diskutime në takimet e klubeve të të rinjve, etj. Kjo do ta bënte programin dhe manualin më motivues dhe tërheqës, dhe më gjithëpërfshirës. Do të ishte një mjet për praktikuesit që të vazhdojnë punën pas një serie punëtorish, duke siguruar më shumë mundësi për të rinjtë për të mësuar në një mënyrë më informale (natyrisht, në një mjedis të sigurt dhe të kontrolluar), për t'u shoqëruar dhe argëtuar, gjë që do të ishte e dobishme, veçanërisht në rastin e grupeve të cënueshme. Zhvillimi i këtij programi dhe manuali do të ishte përpjekje e gjatë, e mundimshme dhe ndoshta e kushtueshme, por rezultatet do të ishin të mëdha dhe do të hapnin më shumë mundësi për përpjekjet e ardhshme.

Për më tepër, një kurs i standardizuar i trajnimit Y + për profesionistë (që punojnë në qendra për punë sociale, institucione për fëmijë pa kujdes prindëror, qendra të paraburgimit për të mitur, shkolla, etj.) mund të zhvillohej dhe akreditohej për përdorim profesional në disa nga projektet e ardhshme të YMI. Akreditimi duhet të kërkohej nga Ministritë përgjegjëse (për çështjet sociale, ose e drejtësisë). Kjo mund të rezultojë në një shtrirje më të madhe midis profesionistëve, si dhe një nivel të caktuar të qëndrueshmërisë.

Përveç zbatimit, proceset e matjes, monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të programit gjithashtu duhet t'i nënshtrohen standardizimit. Domethënë, do të ishte e dobishme nëse dikush do të përdorte modelin e vlerësimit të ngjashëm me hulumtimet rigoroze pikënisje dhe atyre përmbyllëse të kryera brenda Programeve M dhe Y, të cilat kanë gjeneruar një bazë të madhe të provave me kalimin e kohës, duke nxitur më tej suksesin dhe njohjen e YMI. Standardizimi në këtë aspekt do të mundësonte gjithashtu krahasimin jo vetëm midis pikënisjes dhe përmbylljes, por edhe midis vendndodhjeve të projektit. Për aktivitetet e zakonshme edukative siç janë punëtoritë dhe trajnimet, metodat janë të qarta - pyetësorë për kërkime sasiore, dhe fokus grupe, intervista në grupe dhe intervista të thelluara për kërkime cilësore. Nga ana tjetër, nëse keni për shembull shfaqje teatri si aktivitet i projektit, nuk ka asnjë mënyrë të saktë për të matur ndikimin, kryesisht për shkak të

problemeve praktike në lidhje me mënyrën se si duhet të anketohet një audiencë e madhe. Duhet të dilni me ide kreative se si të grumbulloni të dhëna për këtë, disa prej opsioneve janë marrja e një baze të të dhënave me kontakte/emaile të anëtarëve të audiencës, krijimi i sondazheve të shkurtra në internet, ose ndoshta dhënia e një shpërblimi të vogël për njerëzit në audiencë që do të shkruanin recensionin e tyre. Sigurisht, kur dikush tashmë ka formuar një grup të synuar të rinjsh për të punuar me ta, atëherë zhvillimi i një pyetësoi/fokus grupi pas performancës nuk duhet të paraqesë një problem. Gjithashtu, shënimi i Ndryshimit Më të Rëndësishëm (MSC) është metodë e shkëlqyeshme cilësore e përdorur tashmë nga ekipi i YMI, dhe duhet të përdoret më shumë në Programin Y + në të ardhmen, përveç në Programin Y. Përveç kësaj, intervistat dhe historitë e MSC nuk duhet të jenë vetëm veçim i disa citateve - duhet të jetë një intervistë sistematike me pjesëmarrësit dhe palët e interesit nga e cila më vonë mund të nxirren citime nëse është e nevojshme.



2. Ekstremizmi dhe radikalizimi i të rinjve si fenomene të analizuara jo mjaftueshëm

Kur flasim për kërkime, si në pikën e mëparshme, një rekomandim tjetër vjen në mendje - më shumë mundësi për kërkime në shkallë të gjerë mund të hulumtohen brenda programit Y + dhe kornizës së YMI. Temat e ekstremizmit dhe radikalizimit ende nuk janë studiuar sa duhet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. CARE dhe ekipi i YMI mund të konsiderojnë dhe diskutojnë nëse duan të ndjekin këtë rrugë dhe të organizojnë kërkime më të mëdha mbi këto tema, në këto vende të veçanta. Ne tashmë kemi një shembull brenda YMI, hulumtimi i kryer nga Perpetuum Mobile në BeH, i cili tejkaloi pritjet e projektit me një mostër prej mbi 1100 të rinjsh për kërkime sasiore. Metodologjia dhe instrumentet e tyre mund të zhvillohen më tej, një pjesë cilësore mund të shtohet dhe një metodologji e përbashkët për zbatimin e saj në të gjitha vendet e përfshira. Kjo do të mundësonte krahasimin e rezultateve, duke përshtatur gjithashtu një pjesë të pyetësorit me kontekstin lokal. Ne gjithashtu kemi një shembull të hulumtimit të IMAGES që po zbatohet më parë në rajon (në Kroaci, BeH, Serbi dhe Kosovë) i cili u dha rezultate të vlefshme organizatave partnere. Organizata Promundo-US, partneri më i vjetër dhe më i shquar i YMI, iniciatori i IMAGES (dhe i Programit M, për këtë çështje) mund të konsultohet gjithashtu për të gjitha këto çështje, pasi ajo gjithashtu është e përfshirë në tema të rinisë, maskulinitetit dhe ekstremizmit.^{33,34}

33 Sommers, M. (2019). Youth and the Field of Countering Violent Extremism. Washington, DC: Promundo-US

34 Fried, A. with Lauro, G., & Barker, G. (2020). Masculinities and Preventing Violent Extremism: Making the Connections. Washington, DC: Promundo-US



3. Puna me burra të rinj si një gur themeli në parandalimin e radikalizimit dhe dhunës së të rinjve

“Ne e dimë që identiteti mashkullor dhe normat mashkullore janë të lidhura me forma të ndryshme të dhunës, përfshirë dhunën seksuale, vrasjet, ngacmimet, vetëvrasjet dhe dhunën e lidhur me konfliktet. Burrat dhe djemtë janë në mënyrë disproporcionale si autorë të këtyre formave të dhunës ashtu edhe viktima të formave të caktuara si vrasja dhe vetëvrasja (...) në vend që të injorojnë kryesisht ndikimin e normave gjinore në qëndrimet dhe sjelljet, qasjet duhet të fitojnë dhe të përfshijnë një të kuptuar jo vetëm se si këto norma ndikojnë në veprimet e burrave dhe djemve dhe formësojnë dobësitë e tyre në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm, por gjithashtu edhe mënyrat në të cilat veprimi programatik mund të trajtojë pabarazinë gjinore dhe të parandalojë ekstremizmin e dhunshëm në të njëjtën kohë, për një ndikim afatgjatë.”³⁵

Puna e lartpërmendur e Promundo thekson maskulinitetin dhe lidhjen e tij me ekstremizmin e dhunshëm. Ndërsa ka një rritje në pjesëmarrjen e grave në grupe ekstremiste dhe puna me gratë është thelbësore, nuk ka dyshim se “burrat dhe djemtë vazhdojnë të përfaqësojnë shumicën dërrmuese të atyre të rekrutuar në grupe ekstremiste dhe që kryejnë dhunë ekstremiste.” Gjatë fazës së pilotimit Y+, shumica e partnerëve punuan me grupe të të rinjve që kishin rreth gjysmë, dhe nganjëherë më shumë se gjysmë, të grave të reja pjesëmarrëse. Kjo është joproporcionale duke pasur parasysh atë që kemi thënë më parë, që shumica dërrmuese e ekstremistëve janë burra dhe djem. Ne rekomandojmë që në aktivitetet e ardhshme në lidhje me parandalimin e ekstremizmit, ekipi i YMI të përqendrohet përsëri në shënjestrimin në një mënyrë që përfshin një shumicë të qartë të burrave të rinj kur formohen grupe, ose madje edhe duke pasur grupe ekskluzivisht të burrave të rinj. Ngjashëm me mënyrën sesi u bë në Programin M (“Bonu Burrë”), me gjithë arsyetimin e tij metodologjik, ky program duhet të sfidojë normat e dëmshme gjinore dhe të rrisë përvetësimin e qëndrimeve dhe sjelljeve më të barabarta gjinore dhe jo të dhunshme tek burrat e rinj. Të mbledhësh, të angazhosh dhe të motivosh burrat e rinj në rrezik është padyshim më sfiduese, kështu që kjo përfaqëson mënyrën më të vështirë, por do të sillte përpjekje më të përqendruara dhe shënjestrim më të vlefshëm për këtë temë të veçantë të projektit. Puna e Status M me një grup ekskluzivisht të burrave të rinj në Qendrën e Paraburgimit për të Mitur, ku ata faktikisht janë në burg, të privuar dhe të ballafaquar me rrethana që nxisin bashkimin me grupe ekstremiste (si fashistët, neo-nazistët), është një shembull i një grupi të përsosur të shënjestruar për trajtimin e këtyre çështjeve të veçanta.

35 Ibid.




4. Shtrirja tek të rinjtë/rejat në zonat rurale

Gjatë zbatimit të Programit Y +, disa organizata partnere në ekipin e YMI zgjedhën të punojnë me grupe në zonat rurale, jashtë qyteteve ku ata janë të vendosur. Kjo është një zgjedhje shumë e mirë sepse kjo pjesë e popullsisë ka më shumë nevojë për programin, duke marrë parasysh se vijnë nga zona rurale, më tradicionale, me një normë më të ulët të të ardhurave, dhe përgjithësisht me më pak opsione dhe mundësi dhe pa trajnime apo programe të ngjashme, ndonjëherë edhe pa organizata të shoqërisë civile, etj. Nuk është e përshtatshme që të udhëtosh shpesh jashtë qytetit, prandaj grupet në zonat urbane zakonisht kanë më shumë aktivitete. Nëse ekipi i YMI dëshiron të rritet dhe të përhapë shtrirjen e tij në më shumë komunitete në më shumë vendndodhje në të ardhmen, ne do të rekomandonim organizimin e një sesiioni të trajnimit për trajnerë/punëtorë të rinj vendorë dhe krijimin e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me organizatat/institucionet e reja partnere lokale, ku kjo është e mundur. Angazhimi i trajnerëve dhe punëtorëve të rinj vendorë do të ishte shumë i dobishëm për programin, duke pasur parasysh njohuritë e tyre për kontekstin lokal, dhe kështu puna e tyre do të ishte më e rëndësishme, më e përqendruar dhe më efektive.



5. Shkëmbimet rajonale po i bëjnë rininë më pak të prirur për radikalizim

Bashkëpunimi dhe shkëmbimet rajonale janë të dobishme për përpjekjet për ndërtimin e paqes, sigurimin e hapësirave të sigurta për të rinjtë që të takohen, diskutojnë, punojnë së bashku, të thyejnë barrierat, të shoqërohen, etj. YMI ka një histori të organizimit të kampeve ku të rinjtë nga i gjithë rajoni do të takoheshin në këtë mënyrë, dhe këto kampe kanë pasur rezultate të mëdha në vitet e mëparshme. Prandaj, rekomandimi është i qartë - të organizohen kampe të përbashkëta, trajnime, shkëmbime rinore ose aktivitete të ngjashme ku të rinjtë nga të gjitha këto vende të ndryshme dhe prejardhje të ndryshme do të takoheshin, gjë që do të lehtësonte eliminimin e paragjytimeve, stereotipeve, urrejtjes dhe do të rriste jo vetëm tolerancën, por edhe pranimin dhe miqësitë.



6. Të mësuarit nga përvoja me COVID -19

Mes krizës me COVID-19, shumica e njerëzve u mësuan të përdorin platforma online shumë më tepër se më parë, për komunikim por edhe edukim. Ekipi i YMI-së i është përgjigjur në të njëjtën mënyrë pandemisë dhe ka realizuar punëtori të shumta online në të gjitha vendet e projektit. Ne rekomandojmë zhvillimin e vazhdueshëm të metodave arsimore përmes platformave online,

mbase edhe një kurs online për Programin Y + mund të zhvillohet në përpjekjet e ardhshme. Puna online mund të bëhet gjithashtu duke përdorur një metodë të kombinuar, p.sh. disa seanca për t'u regjistruar dhe në dispozicion për t'u parë nga njerëzit (me materiale shoqëruese si literatura dhe teste, gjithashtu në dispozicion), dhe disa seanca të përqendruara më shumë në diskutime, në formën e një uebinari interaktiv. Dhe, sigurisht, disa seanca mund të bëhen me prani fizike. Zhvillimi i një kursi online në të ardhmen, dhe një akreditim i mundshëm i tij, mund të arrijë shumë më tepër pjesëmarrës, dhe gjithashtu të sigurojë një shkallë të caktuar të qëndrueshmërisë.



7. Ndërtimi i kapaciteteve të trajnerëve/edukatorëve

Për të punuar në këto tema, dhe posaçërisht për të punuar me grupe më të cënueshme, këshillohet fuqimisht rritja e kapaciteteve të ekipit të trajnerëve. Trajnerët duhet të sensibilizohen më shumë për grupe të veçanta dhe nevojat e grupeve, duhet të kenë më shumë aftësi për trajtimin e përshkallëzimeve të konflikteve të mundshme (për shembull, në një qendër paraburgimi për të mitur). Nëse trajnerët/edukatorët kanë punuar vetëm në shkolla të mesme të rregullta, ata nuk janë të përgatitur për një formë më intensive pune me të rinjtë në qendrat e paraburgimit, qendrat për punë sociale dhe institucione të tjera rehabilituese, veçanërisht nëse pjesëmarrësit kanë histori të sjelljes së dhunshme. Nëse është e nevojshme, një mundësi tjetër është jashtëkontraktimi, duke angazhuar trajnerë tashmë me përvojë në këtë fushë, posaçërisht për këtë rol. Për avancimin e mëtejshëm të Programit Y + në institucionet sociale, ne këshillojmë fuqimisht trajnime të mëtejshme të trajnerëve dhe edukatorëve kolegial.



8. Edukimi me bazë në teatër si model për parandalimin e radikalizimit të të rinjve

Shfaqja teatrale brenda Y + ishte një sukses i madh, por ka ende hapësirë për pasurim në të ardhmen. Në thelb, të gjithë të intervistuarit e grupit rekomanduan dhe ne jemi dakord, që diskutime të moderuara me audiencën të organizohen, menjëherë pas përfundimit të performancës. Kjo do të mundësonte diskutime më të thelluara, shpjegime, pyetje nga audienca, ndarjen e përshtypjeve dhe sugjerimeve, dhe natyrisht kjo do të forconte pikat kryesore të shfaqjes dhe ndikimin e saj. Një sugjerim tjetër nga grupi, me të cilin pajtohemi plotësisht, është që metodat e edukimit të bazuara në teatër duhet të zhvillohen më tej - një program teatri forumi mund të zhvillohet bazuar në shfaqjen ekzistuese, si imitimi i shfaqjes. Një metodë e teatrit forum do të ishte e dobishme, sepse situatat problematike të konceptuara së pari do të interpretoheshin në skenë, dhe pastaj pjesëmarrësit do të kishin një shans për të hyrë në skenë dhe për të bërë diçka që sipas tyre do të zgjidhte problemin. Kjo i jep hov mendimit kritik dhe angazhimit të audiencës përmes metodave ndërvepruese.




9. Kundër narrativat si mjete të fuqishme të fushatës

Fushata për parandalimin e ekstremizmit e zhvilluar në YMI filloi në pranverën e vitit 2020, me kapacitet të kufizuar për shkak të pandemisë së koronavirusit, vetëm me aktivitete online (postime dhe aktivizime në media sociale, kuize online, etj.). Natyrisht, aktivitetet “offline” që ishin planifikuar, veprimet publike me mesazhe të qarta, duhet të realizohen në të ardhmen, dhe në atë mënyrë të arrijnë njerëzit në hapësira offline dhe online. Ide tjetër që mund të shtjellohet më tej është përdorimi i kundër narrativave në këtë fushatë, për shembull zhvillimi dhe promovimi i videoklipeve që përdorin kundër narrativa. Për të dhënë një shembull të thjeshtë, në disa vende, një organizatë ekstremiste “përfaqëson interesat” (padyshim rrejshëm) të shumicës së popullsisë A dhe promovon urrejtje dhe dhunë ndaj grupit B. Pastaj, ekipi i YMI identifikon këtë çështje dhe vendos të adresojë probleme të veçanta në një vend të caktuar ose në komunitet lokal. Pastaj, zhvillohet “kundër” videoja ku njerëzit nga grupi A dhe grupi B paraqiten si bashkëpunues, miq, me marrëdhënie domethënëse, etj. Skenaret për këto video padyshim që do të vareshin nga çështjet e identifikuar dhe videot duhet të zhvillohen me kujdes, gjithmonë duke pasur parasysh ndjeshmërinë e çështjes së përfshirë.



Si përfundim, ne mund të themi me bindje se ky program ishte një pilotim i suksesshëm i qasjeve dhe metodave të ndryshme për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit tek të rinjtë. Ai demonstroi kreativitetin dhe përkushtimin e organizatave partnere pjesëmarrëse, dhe cilësinë e lartë të qasjeve të tyre specifike. Nuk ka dyshim se aktivitetet e realizuara ishin shumë të dobishme për pjesëmarrësit e rinj, dhe Y + pa dyshim që u dëshmuua si program (ose grupe programesh) parandalues premtues. Megjithatë, ka ende punë për të bërë. Meqenëse kjo ishte në thelb provë e metodave të ndryshme, dhe një lloj pune në progres, ajo i dha ekipit të YMI shumë opsione, dhe prova dhe njohuri të vlefshme për përpjekjet e ardhshme për të trajtuar këto çështje komplekse. Për më tepër, Programi Y + duhet të vazhdojë zhvillimin në periudhën vijuese dhe duhet të finalizohet duke pasur parasysh nevojën e identifikuar për standardizim, në përputhje me rekomandimet e tjera të ofruara këtu. Vetëm me punë të vazhdueshme dhe përmirësime të mëtejshme, programi Y + do të arrijë potencialin e tij të plotë dhe të bëhet programi efektiv, i mirëbalancuar, gjithëpërfshirës dhe i shkallëzuar që siguron rezultate në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit të të rinjve, në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.





**Partnerët
pjesëmarrës**

5. Partnerët pjesëmarrës



Vepro për Shoqërinë

Tiranë, Shqipëri

 www.actforsocietycenter.org



Qendra E8

Beograd, Serbi

 www.e8.org.rs



Perpetuum Mobile

Banjallukë, Bosnje dhe Hercegovinë

 www.pm.rs.ba



SIT - Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime

Prishtinë, Kosovë

 www.sit-ks.org



Status M

Zagreb, Kroaci

 www.status-m.hr

Kontakti:

 www.youngmeninitiative.net

Zyret ndërkombëtare të CARE në Ballkan:

 Hasana Kaimije 11
71000 Sarajevë
Bosnjë dhe Hercegovinë

 +387 33 536 790
 care@care.ba

 Aleja Svetog Save 7a
78000 Banja Luka
Bosnjë dhe Hercegovinë

 +387 51 258 200
 spetkovic@care.ba

 Kneza Visislava 88
11000 Beograd
Serbi

 +381 11 7706 696
 emilenkovic@care.rs

 Gazmend Zajmi 21
10 000 Prishtinë
Kosovë

 +381 (0) 38 224 779; 222 435
 care.kosovo@care.org



Literatura

1. Allan, H., Glazzard, A., Jespersen, S., Reddy-Tumu, S. and Winterbotham, E. (2015) Drivers of Violent Extremism: Hypotheses and Literature Review, Royal United Services Institute A (Shtytësit e Ekstremizmit të Dhunshëm: Hipotezat dhe Rishikimi i Literaturës), Instituti Mbretëror i Shërbimeve të Bashkuara
2. Azinović, V. (2018). Extremism Research Forum, Regional Report – Understanding Violent Extremism in the Eastern Balkans, British Council (Forumi i Hulumtimeve për Ekstremizmin, Raporti Rajonal – Të Kuptuarit e Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkanin Perëndimor), Këshilli Britanik
3. Backes, U. (2007). Meaning and Forms of Political Extremism in Past and Present. Central European Political Studies Review. 9(4), 242-262. (Kuptimi dhe format e ekstremizmit politik në të kaluarën dhe të tashmen),
4. Center for Prevention of Radicalisation Leading to Violence (CPRL). (Qendra për Parandalimin e Radikalizimit që Çon në Dhunë) në dispozicion në: <https://info-radical.org/en/>
5. Committee of Experts on Terrorism (2016). Profiles on counter-terrorism capacity. Komiteti i Ekspertëve për Terrorizmin. (Profile mbi kapacitetin antiterrorizëm), në dispozicion në: <https://rm.coe.int/168064100f>
6. Denoeux, G. dhe Carter, L. (2009). Guide to the Drivers of Violent Extremism. (Udhëzues për Shtytësit e Ekstremizmit të Dhunshëm), Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
7. Dušanić, S. (2020). Mladi i ekstremizam. Perpetuum mobile – Institut za razvoj mladih i zajednice, Banja Luka.
8. Bashkimi Evropian (2005). Addressing the factors contributing to violent radicalization (Report # COM-2005 313). Brussels, Belgium: European Union Council Concerning Terrorist Recruitment and Commission, European Parliament. (Adresimi i faktorëve që kontribuojnë në radikalizimin e dhunshëm (Raporti # COM-2005 313). Bruksel, Belgjikë: Këshilli i Bashkimit Evropian në lidhje me Rekrutimin Terrorist dhe Komisioni, Parlamenti Evropian)
9. Fried, A. dhe Lauro, G., & Barker, G. (2020). Masculinities and Preventing Violent Extremism: Making the Connections. Washington, DC: Promundo-US. (Maskulinitetet dhe parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm: krijimi i lidhjeve. Uashington, DC: Promundo-SH.B.A.) në dispozicion në: https://promundoglobal.org/ep-content/uploads/2020/07/BLS20227_PRO_Violent_Extremism_006.pdf
10. James, K. dhe Zeuthen, M. (2016). Countering Violent Extremism and Risk Reduction: A Guide to Programme Design and Evaluation, Whitehall, London: Royal United Services Institute (Kundërshtimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe zvogëlimi i rrezikut: Një udhëzues për hartimin dhe vlerësimin e programit, Whitehall, Londër: Instituti Mbretëror i Shërbimeve të Bashkuara)

11. Leuven, D.V. (2019). Countering Violent Extremism: An Introductory Guide to Concepts, Programming, and Best Practices, (Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Një udhëzues hyrës për konceptet, programimin dhe praktikat më të mira) Search for Common Ground.
12. Mattei, C. dhe Zeiger, S. (2018). Evaluate your CVE results: Projecting your impact. (Vlerësoni rezultatet tuaja të CVE: Projektimi i ndikimit tuaj). Hedayah, 2018
13. OEBS (2018). The Role of Civil Society in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism. (Roli i shoqërisë civile në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm). Vjenë: Austri.
14. Pressman, D.E. (2009). Risk Assessment Decisions for Violent Political Extremism 2009-02. (Vendimet e vlerësimit të rrezikut për ekstremizmin e dhunshëm politik 2009-02). Ottaëa, Ont.: Siguria Publike Kanada.
15. Silber, M. D., & Bhatt, A. (2007). Radicalization in the ëest: The homegroën threat. Neë York: Neë York Police Department Intelligence Division. (Radikalizimi në perëndim: Kërcënimi i prodhuar brenda. New York: Divizioni i Inteligjencës i Departamentit të Policisë së Nju Jorkut)
16. Sommers, M. (2019). Youth and the Field of Countering Violent Extremism. Washington, DC: Promundo-US (Rinia dhe Fusha e Luftimit të Ekstremizmit të Dhunshëm. Uashington, DC: Promundo-SH.B.A.) në dispozicion në: <https://promundoglobal.org/resources/youth-and-the-field-of-countering-violent-extremism/>
17. Slachmujlder, L. (2017). Transforming Violent Extremism: A peacebuilder's guide, 1st ed. (Transformimi i Ekstremizmit të Dhunshëm: Një udhëzues i ndërtuesit të paqes, botimi i parë). Uashington DC: Search for Common Ground.
18. Trebješnin, Ž. (2007). Psihologija političkog ekstremizma. Beograd, Srbija: Hereticus
19. UNDP (2016). Preventing Violent Extremism through Inclusive Development and the Promotion of Tolerance and Respect for Diversity: A Development Response to Addressing Radicalization and Violent Extremism, (Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes zhvillimit gjithëpërfshirës dhe promovimit të tolerancës dhe respektit të diversitetit: një përgjigje zhvillimore për adresimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm). Dokument diskutimi, UNDP
20. USAID (2011). The Development Response to Violent Extremism and Insurgency. (Përgjigja zhvillimore ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe kryengritjes). Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), në dispozicion në: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pdacs400.pdf
21. Weert, A. i Eijkman, Quirine. (2018). Subjectivity in detection of radicalisation and violent extremism: a youth ëorker's perspective. Behavioral Sciences of Terrorism and Political Aggression, 1-24. (Subjektiviteti në zbulimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm: perspektiva e një punëtori rinor. Shkencat Biheviorale të Terrorizmit dhe Agresionit Politik, 1-24)



Puna me të Rinjtë/Rejat në Rrezik në Ballkan

Një rast studimor mbi Programin Y +



With funding from
= Austrian
Development
Cooperation

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

 OAK
FOUNDATION

 Young
Men
Initiative